Sundimi i Ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE

dokument tremujor

korrik-shtator 2025

Instituti për politikë evropiane. Shkup

Ky proekt finansohet nga Bashkimi Evropian

Sundimi i ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE

Dokument tremujor korrik-shtator 2025

Botues:
Instituti për politikë evropiane - Shkup

Për botuesin:
Dr. Simonida Kacarska

Redaktorët:
Dr. Simonida Kacarska
Dr. Ardita Abazi Imeri

Autorë:
Ardita Vejseli
Beba Zhagar
Juljana Karai
Petar Barlakovski

Përkthim nga gjuha angleze në gjuhën shqipe:
Blerina Starova Zlatku

Dizajn grafik:
Relativ

Shkup, 2025

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Ndërtojmë urë për një të ardhme të përbashkët: Sundimi i së drejtës në drejtim të aderimit në BE", i financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe assesi nuk mund të konsiderohet se i përfaqëson qëndrimet dhe pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Ky dokument përmbledh zhvillimet kryesore në lidhje me sundimin e ligjit në kontekst të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në BE për periudhën korrik – shtator 2025. Ai përfshin **monitorimin e themeleve të anëtarësimit në BE, duke mbuluar zhvillimet kryesore në funksionimin e institucioneve demokratike, reformën e administratës publike dhe kapitullin 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore.**

Zhvillimet kryesore

- Në korrik u miratuan tre ligjet kryesore të RAP: Ligji për nëpunësit administrativë, Ligji për nëpunësit e sektorit publik dhe Ligji për zhvillimin profesional të nëpunësve administrativë.
- U miratua Programi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (MFP) për periudhën 2025-2028, së bashku me Planin e tij të Veprimit për vitin 2025.
- Në fillim të gushtit, Kuvendi shpalli zgjedhjet e ardhshme lokale - të tetat që nga pavarësia e vendit.
- Në të njëjtën kohë, u publikua një njoftim për zgjedhjen e një kryetari të ri të KSHPK-së; megjithatë, përzgjedhja u pezullua për shkak të zgjedhjeve lokale në pritje në vend.
- KSHZ miratoi një rregullore të re që lejon kandidatët e pavarur të garojnë në zgjedhjet e ardhshme lokale nëse ato miratohen nga nënshkrimet e vetëm dy qytetarëve.
- U formua Komisioni i ri për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë në GJEDNJ dhe në shtator u publikua një thirrje e re publike për aplikime.
- Në korrik, Kuvendi vendosi të lëshojë një thirrje publike për zgjedhjen e një Avokati të ri të Popullit; megjithatë, përzgjedhja nuk është bërë ende, dhe kështu zyra e Avokatit të Popullit tani funksionon me vetëm dy zëvendës Avokat të Popullit për gjithë vendin.
- U publikua propozimligji për Ligjin për Provën.
- Në shtator u miratua Ligji për Qasshmërinë e Ueb-faqeve dhe Aplikacioneve Mobile të Institucioneve të Sektorit Publik.
- Në fund të shtatorit, u mbajt seanca konstituive e Trupit Kombëtar Koordinues për Zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.
- Në gusht, u miratua Plani Kombëtar i Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2025-2029.

Listë e shkurtesave

AA	Agjencia e Administratës
ASHMAA	Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele
SHGM	Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë
ZPTHP	Zyra e Prokurorisë Themelore Publike
PTHPNKOK	Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
CEF	Qendra e Ekselencës në Financa
KPMD	Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi
OShC	Organizata të shoqërisë civile
CUP	Qendra për menaxhim me ndryshimet
DGAFP	Drejtoria e Përgjithshme për Administratën dhe Shërbimin Civil
BDI	Bashkimi Demokratik për Integrim
KEDNj	Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
GJEDNj	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
ENER	Regjistri i Vetëm Kombëtar Elektronik
PE	Parlamenti Evropian
BE	Bashkimi Evropian
GRECO	Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit
AI	Agjencia e Inteligjencës
INSP	Instituti Kombëtar i Administratës Publike të Francës
LGBTI+	Komunitetet lezbike, homoseksuale, biseksuale, trans dhe interseksuale
MASH	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme
Deputet	Deputet
MAP	Ministria e Administratës Publike
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
ASK	Agjencia e Sigurisë Kombëtare
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
RAP	Reforma e Administratës Publike
AMDP	Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
ReSPA	Shkolla Rajonale e Administratës Publike
ESHR	Enti Shtetëror për Revizion
KSHPK	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
KSHZ	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
SIGMA	Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe të Menaxhimit
LSDM	Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë
SPGPM	Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik
SPACE I	Statistika Penale Vjetore për Popullsinë e Burgjeve
KB	Kombet e Bashkuara
KKBDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës
SPASH	Sindikata e Punonjësve në Administratën Shtetërore
VMRO-DPMNE	Organizata e brendshme revolucionare maqedonase – Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas
LOPOASH	Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore

Përmbajtja

Funksionimi i Institucioneve Demokratike **6**

Zgjedhjet 7
Qeverisja 9
Shoqëria civile 10
Mbikqyrja civile dhe sektori i sigurisë/inteligjencës 10
Reforma e administratës publike 11

Kapitulli 23 ..... **13**

Funksionimi i gjyqësorit 14
Organet menaxhuese 14
Pavarësia dhe paanshmëria 14
Llogaridhënia 14
Profesionalizmi dhe kompetenca 14
Cilësia e drejtësisë 15
Efikasiteti 16

Lufta kundër korrupsionit 17
Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit 17
Zyra e Prokurorit Publik 18

Të drejtat themelore 20
Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut 20
Avokati i Popullit 21
Burgu dhe objektet e paraburgimit 22
Mbrojtja e të dhënave personale 23
Liria e shprehjes 23
Grupet e cenueshme dhe parimi i mosdiskriminimit 25
Gjinia 26
Të drejtat e fëmijës 28
LGBTI+ 28
Roma 29

Funksionimi i institucioneve demokratike

Zgjedhjet

Më 9 gusht, Kryetari i Kuvendit shpalli zgjedhjet e ardhshme lokale - të tetat që nga pavarësia e vendit. Raundi i parë i zgjedhjeve për kryetarë komunash dhe këshilltarë në 80 komuna dhe Qytetin e Shkupit do të mbahet më 19 tetor. Në komunat ku zgjedhjet për kryetar komune nuk përfundojnë në raundin e parë, raundi i dytë është caktuar për 2 nëntor. Gjatë këtyre zgjedhjeve, qytetarët do të votojnë për kryetarët e komunave dhe këshilltarët komunalë në 80 komuna, përfshirë Qytetin e Shkupit.[1] Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) miratoi afatet për mbajtjen e zgjedhjeve lokale në të njëjtën ditë, pas shpalljes së tyre të mëparshme nga Kryetari i Kuvendit. Fushata zgjedhore për raundin e parë fillon më 29 shtator dhe do të zgjasë vazhdimisht deri më 17 tetor. Fushata për raundin e dytë zgjedhor do të zgjasë deri më 31 tetor.[2] Vetëm disa ditë më vonë, ish-kryetarja e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) dhe kandidatja aktuale e pavarur për kryetare të Komunës Qendër njoftoi në profilin e saj në Facebook se, vetëm 11 orë pas shpalljes së kandidaturës së saj, oficerët e policisë arritën në shtëpinë e saj për ta informuar atë për procedurat penale të nisura kundër saj.[3] Prokuroria Themelore Publike në Shkup deklaroi akuzat penale kundër ish-kryetares të KSHPK-së dhe kandidates aktuale të pavarur për kryetare të Komunës Qendër, duke theksuar se kjo ishte thjesht një ftesë për pyetje dhe nuk kishte asnjë lidhje me aktivitetet e saj politike.[4] Të nesërmen, në një seancë të veçantë, Kuvendi votoi për ndryshimet e propozuara në Kodin Zgjedhor që do të kërkonin lista të pavarura të këshilltarëve dhe kandidatëve për kryetar komune për të mbledhur nënshkrime nga 0.95 përqind e votuesve të regjistruar në komunën përkatëse ose Qytetin e Shkupit. Gjatë debatit të komitetit, partia politike Levica propozoi një ndryshim për të ulur pragun nga 0.95 përqind në 0.5 përqind - një ndryshim i mbështetur nga të gjitha partitë përveç Frontit Evropian. Kur propozimi u kthye në seancë plenare, 66 deputetë votuan pro dhe 18 kundër. Megjithatë, gjatë votimit të komuniteteve jo-shumicë, 11 deputetë mbështetën ndryshimet ndërsa 18 votuan kundër, duke rezultuar në refuzimin e tyre për shkak të mungesës së shumicës së Badinterit.[5]

Të nesërmen, KSHZ miratoi një rregullore të re që lejon kandidatët e pavarur të garojnë në zgjedhjet e ardhshme lokale me miratimin e vetëm dy qytetarëve. Sipas këtij rregulli, kandidatët e pavarur për postet e kryetarit të komunës dhe këshilltarëve duhet të mbledhin dy nënshkrime për t'u kualifikuar për pjesëmarrje. Vendimi u miratua në një seancë me gjashtë vota pro dhe një kundër. Rregullorja u propozua nga një anëtar i KSHZ-së, i cili iu referua nenit 63 të Kodit Zgjedhor, duke vënë në dukje se ai mbetet në fuqi dhe rregullon procedurën për mbledhjen e nënshkrimeve për nominimet e kandidatëve, pavarësisht se neni 62 - që ka të bëjë posaçërisht me zgjedhjet lokale - u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese.[6] Më pas, një anëtar i KSHZ-së paraqiti një padi në Gjykatën Administrative, duke kundërshtuar udhëzimin e KSHZ-së për numrin e këshilltarëve komunalë, pas një vendimi të qeverisë bazuar në regjistrimin e vitit 2021 që zvogëloi numrin

1 Vendimi për thirrjen e zgjedhjeve për anëtarët e këshillave komunalë dhe këshillit të Qytetit të Shkupit, dhe për nënkryetarët e komunave dhe për kryetarin e Qytetit të Shkupit (Решение за распишување на избори за членови на советите на општините и советот на Град Скопје и за градоначалници на општините и за градоначалник на Град Скопје)) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, 9 gusht 2025, https://www.sec.mk/lokalni-izbori-2025/

2 Ibid

3 Ivanovska: 11 orë pasi shpalla kandidaturën time për kryetare të Komunës Qendër, oficerët e policisë trokitën në derën time (Ивановска: 11 часа откако ја објавив кандидатурата за градоначалничка на Општина Центар, полицајци затропаа на мојата врата), 360 Stepeni, 15 gusht 2025, https://360stepeni.mk/ivanovska-11-chasa-otkako-ja-objaviv-kandidaturata-za-gradonachalnichka-na-opshtina-tsentar-politsajtsi-zatropaa-na-mojata-vrata/

4 Prokuroria për akuzat penale kundër Ivanovskës: Ftesa për pyetje nuk lidhet në asnjë mënyrë me aktivitetet e saj politike (Обвинителството за кривичната пријава за Ивановска: Поканата за испитување во ниту еден случај не е поврзана со нејзините политички активности), 360 Stepeni, 15 gusht 2025, https://360stepeni.mk/obvinitelstvo-za-krivichnata-prijava-za-ivanovska-pokanata-za-ispituvane-vo-nitu-eden-sluchaj-ne-e-povrzana-so-nejzinite-politichki-aktivnosti/

5 Ndryshimet në Kodin Zgjedhor nuk kaluan – u miratua një ndryshim, por nuk kishte shumicë të Badinterit (Не поминаа измените на Изборниот законик – се усвои амандман, но немаше бадинтер), Fokus, 16 gusht 2025, https://fokus.mk/ne-pominaa-izmenite-na-izborniot-zakonik-se-usvoi-amandman-no-ne-mashe-badinter/

6 KSHZ miraton rregulloren – të pavarurit të kandidohen në zgjedhjet lokale me dy nënshkrime qytetare (ДИК донесе правилник – независните да се кандидираат на локалните избори со два граѓански потписа), 360 Stepeni, 17 gusht 2025, https://360stepeni.mk/dik-donese-pravilnik-nezavisnite-da-se-kandidiraat-na-lokalnite-izbori-so-dva-graganski-potpisa/

e këshilltarëve në 14 komuna. Vendimi u miratua me pesë vota pro dhe një kundër, pavarësisht kërkesës së anëtarit të KSHZ-së për votim konsensual. Komuna e Gostivarit kishte uljen më të madhe, nga 31 në 23 këshilltarë, duke reflektuar një rënie të popullsisë nga 80,000 në 2002 në 60,000 në 2021. Partia opozitare BDI gjithashtu apeloi në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar se vendimi ishte antikushtetues dhe kishte margjinalizuar shqiptarët. Në të njëjtën kohë, VLEN kritikoi BDI-në që lejoi të bëhej dallimi midis rezidentëve dhe jorezidentëve në regjistrim.[7] Në shtator, Kuvendi miratoi Deklaratën për mbajtjen e zgjedhjeve të drejta, të lira dhe demokratike për këshillat komunale dhe të Qytetit të Shkupit, me 73 vota pro dhe asnjë kundër. E paraqitur nga Kryetari i Kuvendit dhe koordinatorët e grupeve parlamentare, Deklarata thekson unitetin jopartiak, respektimin e të drejtës së votës së qytetarëve dhe dënimin e votimit familjar dhe në grup si një mjet për të manipuluar rezultatet e zgjedhjeve.[8] Më pas, Gjykata Kushtetuese vendosi të mos fillojë procedurat në lidhje me Rregulloren e KSHZ-së, e cila lejon kandidatët e pavarur për kryetar komune dhe këshilltarë të garojnë në zgjedhjet lokale të 19 tetorit me vetëm dy nënshkrime të qytetarëve. Gjykata arriti në përfundimin se veprimi i KSHZ-së ishte i nevojshëm për të siguruar që qytetarët e pavarur të mund të merrnin pjesë në procesin zgjedhor dhe për të mbrojtur Kushtetutën dhe Kodin Zgjedhor.[9]

Gjithashtu, disa ditë më vonë, Gjykata Kushtetuese ndaloi fillimin e procedurave në lidhje me vendimin e Qeverisë për uljen e numrit të këshilltarëve në komuna të caktuara. Pas seancës së 20-të, Kryetari i Gjykatës dhe Gjyqtari Raportues mbajtën një konferencë për shtyp për të adresuar pyetjet në lidhje me vendimin për përcaktimin e numrit të këshilltarëve komunalë në Maqedoni. Lënda arriti në Gjykatë pasi u paraqitën tre iniciativa nga deputetët e Frontit Evropian duke kundërshtuar vendimin e Qeverisë.[10] Në fund të muajit, KSHZ-ja finalizoi listën e votuesve, duke konfirmuar se 1,832,415 qytetarë kishin të drejtë vote. Kjo përfshinte 112,000 votues përkohësisht jashtë vendit, 2,162 votues në paraburgim ose në vuajtje të dënimeve me burg dhe 450 votues që banonin në shtëpi për të moshuar.[11] Së fundi, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (ASHMAA) miratoi njëzëri udhëzimet për transmetuesit për zgjedhjet lokale të vitit 2025, duke mënjanuar në mënyrë efektive partinë Levica nga qasja në reklamat politike me pagesë. Si përgjigje, Levica paraqiti një ankesë në ASHMAA, duke argumentuar se udhëzimet diskriminojnë partitë më të vogla parlamentare dhe duke kërkuar rishikim urgjent.[12]

7 Ditmire Shehu paraqiti padi në Gjykatën Administrative kundër KSHZ-së për zvogëlimin e numrit të këshilltarëve (Дитмире Шеху поднесе тужба до Управен суд против ДИК за намалувањето на бројот на советници), Telma TV, 25 gusht 2025, https://telma.com.mk/2025/08/25/ditmire-shehu-podnese-tuzhba-do-upraven-sud-protiv-dik-za-namaluvaneto-na-brojot-na-sovetniczi/

8 Kuvendi miratoi Deklaratën për Zgjedhje të Drejta, të Lira dhe Demokratike (Собранието изгласа Декларација за фер, слободни и демократски избори), Nova Makedonija, 12 shtator 2025, https://novamakedonija.com.mk/makedonija/sobranieto-izglasa-deklaracija-za-fer-slobodni-i-demokratski-izbori/

9 Gjykata Kushtetuese nuk ka filluar procedurat në lidhje me Rregulloren e KSHZ-së: Të pavarurit mund të marrin pjesë në zgjedhje me dy nënshkrime (Уставен не поведе постапка за Правилникот на ДИК: Независните може да учествуваат на избори со два потписи), 360 Stepeni, 17 shtator 2025, https://360stepeni.mk/ustaven-ne-povede-postapka-za-pravilnikot-na-dik-nezavisnite-mozhe-da-uchestvuvaat-na-izbori-so-dva-potpisi/

10 Gjykata Kushtetuese nuk filloi procedura në lidhje me vendimin e qeverisë për të zvogëluar numrin e këshilltarëve në disa komuna (Уставен не поведе постапка за владината одлука за намален број советници во дел од општините), Fokus, 24 shtator 2025, https://fokus.mk/ustaven-ne-povede-postapka-za-vladina-ta-odluka-za-namalen-broj-sovetnitsi-vo-del-od-opshtinite/

11 KSHZ ka finalizuar listën e votuesve – 1,832,415 votues kanë të drejtë vote (ДИК го заклучи избирачкиот список – право на глас имаат 1 832 415 избирачи), 360 Stepeni, 26 shtator 2025, https://360stepeni.mk/dik-go-zakluchi-izbirachkiot-spisok-pravo-na-glas-imaat-1-832-415-izbirachi/

12 Miratohet udhëzimi i diskutueshëm – Levica nuk do të jetë në gjendje të reklamohet (Усвоено спорното упатство – Левица нема да може да се рекламира), Televizija 24, 26 shtator 2025, https://24.mk/details/usvoeno-spornoto-upatstvo-levica-nema-da-mozhe-da-se-reklamira

Qeverisja

Prindërit e viktimave të zjarrit tragjik në Koçani vazhduan protestat e tyre. Gjatë periudhës raportuese, ata, së bashku me të afërmit, miqtë dhe mbështetësit, marshuan nëpër qytet çdo të shtunë në "Marshin e Engjëjve", duke kërkuar drejtësi dhe përgjegjësi për viktimat.[13] Lidhur me procedurat gjyqësore në lidhje me zjarrin në Koçani, lënda - e iniciuar pas ngritjes së aktakuzës nga Prokuroria Themelore Publike e Koçanit në Gjykatën Themelore të Koçanit - është transferuar në Gjykatën Themelore Penale të Shkupit. Kjo pasoi një vendim të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila pranoi propozimin dhe caktoi Gjykatën Themelore Penale të Shkupit si kompetente për të trajtuar aktakuzën. Gjykata Supreme e mori këtë vendim pasi përcaktoi se Gjykatat Themelore në Shtip dhe Strumicë nuk kanë një numër të mjaftueshëm gjyqtarësh penalë.[14]

Në korrik, Kuvendi, me 71 vota pro dhe asnjë kundër ose abstenim, miratoi interpelancën për punën e Prokurorit Publik të Shtetit, të paraqitur nga partia Levica. Ai arriti në përfundimin se pretendimet kundër prokurorit ishin të arsyeshme dhe ia përcolli këtë konkluzion Qeverisë dhe Prokurorit Publik të Shtetit.[15] Të nesërmen, Prokurori Publik i Shtetit njoftoi se nuk do të dorëhiqej, përkundrazi do të përqendrohej edhe më shumë në punën e tij.[16]

Ndërkohë, Ministri i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme (MPJ) dhe Sekretari i Jashtëm Britanik nënshkruan një Deklaratë mbi një Partneritet Strategjik midis Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë së Bashkuar në Zyrën e Punëve të Jashtme në Londër. Sipas ministrit, marrëveshja forcon marrëdhëniet strategjike midis dy vendeve, duke rritur bashkëpunimin në politikën e jashtme, sigurinë dhe mbrojtjen, veçanërisht brenda NATO-s.[17]

Në të njëjtën kohë, u nënshkruan gjithsej 828 projekte me vlerë prej 225 milionë euro midis Qeverisë dhe komunave që aplikuan dhe u përzgjodhën në thirrjen e dytë për financim përmes kredisë hungareze. Pjesa më e madhe shkoi për transportin, me 132 milionë euro për 589 projekte, pasuar nga 143 projekte në sektorin e mjedisit dhe 48 projekte në arsim.[18]

Së fundi, MPJ ftoi ambasadorin bullgar të japë një dekret zyrtar në përgjigje të deklaratave të ministrit të jashtëm bullgar. Gjatë një paraqitje televizive, ministri pretendoi se duke hequr referencat për "gjuhën dhe identitetin maqedonas" nga raporti i Parlamentit Evropian (PE) për Maqedoninë e Veriut, ata parandaluan që PE të përdorej për propagandë politike të brendshme nga Kryeministri ose "Maqedonia e Veriut". MPJ ia përcolli dekretin ambasadorit bullgar, duke vënë në dukje papërshtatshmërinë dhe sjelljen diplomatike të papranueshme të deklaratave të tilla publike nga një zyrtar i lartë qeveritar.[19]

13 Sot në Koçan do të mbahet "Marshi i 24-të për Engjëjt" (Во Кочани денеска се одржи 24. „Марш за ангелите"), AIM, 27 shtator 2025, https://bit.ly/48ManBN

14 Aktakuza për zjarrin në "Puls" nga Koçani ka arritur në Gjykatën Themelore Penale në Shkup (Обвинителниот акт за пожарот во "Пулс" од кочанскиот стигна во Основниот кривичен суд Скопје), 360 Stepeni, 2 korrik 2025, https://360stepeni.mk/obvinitelniot-akt-za-pozharot-vo-puls-od-kochanskiot-stigna-vo-osnovniot-krivichen-sud-skopje/

15 Kuvendi votoi mbi interpelancën për Ljupço Kocevski (Собранието ја изгласа интерпелацијата за Љупчо Коцевски), DW News, 29 korrik 2025, https://www.dw.com/mk/sobranieto-ja-izglasa-interpelacijata-za-republickiot-javen-obvinitel-lupco-kocevski/a-73454933

16 Kocevski: Unë nuk do të jap dorëheqjen, do t'i përkushtohem punës sime edhe më me zell (Коцевски: Нема да поднесам оставка, уште поревносно ќе се посветам на работата), 360 stepeni, 30 korrik 2025, https://360stepeni.mk/kotsevski-nema-da-podnesam-ostavka-ushte-porevnosno-ke-se-posvetam-na-rabotata/

17 Mucunski dhe Lami nënshkruan Deklaratën e Partneritetit Strategjik (Муцунски и Лами ја потпишаа Декларација за стратешко партнерство), Kanal 5 TV, 17 korrik 2025, https://kanal5.com.mk/mucunski-i-lami-ja-potpishaa-deklaracija-za-strateshko-partnerstvo/a708648

18 Marrëveshjet nga thirrja e dytë për financimin e projekteve të infrastrukturës nga kredia hungareze u nënshkruan në Qeveri (Во Владата се потпишаа договорите од вториот повик за финансирање на инфраструктурни проекти од унгарскиот кредит), 360 Stepeni, 17 korrik 2025, https://360stepeni.mk/vo-vladata-se-potpishaa-dogovorite-od-vtoriot-povik-za-finansirane-od-ungarskiot-kredit/

19 Ministria e Punëve të Jashtme thirri ambasadorin bullgar në vend për bisedime lidhur me deklaratat e Georgievit. (МНР го повика бугарскиот амбасадор во земјава на разговор поради изјавите на Георгиев), 360 Stepeni, 10 korrik 2025, https://360stepeni.mk/mnr-go-povika-bugarskiot-ambasador-vo-zemjava-na-razgovor-poradi-izjavite-na-georgiev/

Shoqëria Civile

Më 25 shtator, u mbajt seanca e katërt e Këshillit për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile. Seanca përfshiu pikat e mëposhtme: Rregulloren e Punës dhe Programin e Punës 2025-2026 të Këshillit për Bashkëpunim midis Qeverisë dhe Shoqërisë Civile; ndryshimet e propozuara në Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet; raportin e vitit 2024 për financimin e aktiviteteve të shoqatave dhe fondacioneve nga buxhetet shtetërore dhe lokale; raportin për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Këshillit në Komisionin për Shpërndarjen e Burimeve Financiare; dhe emërimin e një përfaqësuesi të shoqërisë civile për grupin e punës që harton Strategjinë e Transparencës 2027-2029.[20]

Mbikëqyrja Civile e Sektorit të Sigurisë/ Zbulimit

Në gusht, u raportua se Agjencia e Sigurisë Kombëtare (ASK) paraqiti tre padi në Prokurorinë Publike në lidhje me një ish-drejtor dhe disa punonjës të ASK-së, duke pretenduar sjellje të paligjshme, joprofesionale dhe joetike. Sipas ASK, raportet paditë nga një hetim i brendshëm i kryer pas ndryshimit të qeverisë në vitin 2024 dhe mbulojnë veprimet midis 2019 dhe 2024.[21]

Pas kësaj, një seancë e Komisionit për Mbikëqyrjen e Punës së ASK-së dhe Agjencisë së Inteligjencës (AI) ishte caktuar për 5 shtator për të shqyrtuar pretendimet për përgjime të paligjshme midis 2019 dhe 2024, por u shty. Deputetët si nga VMRO-DPMNE në pushtet ashtu edhe nga LSDM-ja opozitare kishin bërë thirrje për seancë pas pretendimeve të drejtorit aktual të ASK-së dhe Kryeministrit se përgjimi i paligjshëm ndodhi gjatë asaj periudhe.[22]

Më 10 shtator, Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e ASK-së dhe AI-së votuan me shumicë dërrmuese për të kryer një vizitë mbikëqyrëse në ASK, mes akuzave për përgjim dhe sjellje joprofesionale midis 2019 dhe 2024. Gjatë vizitës, deputetët shqyrtuan dokumentet dhe shqyrtuan fushën e veprimeve të pretenduara të paligjshme, joetike dhe joprofesionale nga ish-drejtori dhe stafi. Ata theksuan se mbikëqyrja i shërben interesit publik dhe shprehën shpresën për të paktën deklasifikimin e pjesshëm të dokumenteve për të siguruar një raport të detajuar. Pyetjet kryesore u përqendruan në rolet e personelit të lartë dhe masat e marra kundër aktorëve politikë gjatë kohës që ata ishin në opozitë.[23] Pasi anëtarët e Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Punës së ASK-së dhe AI-së zhvilluan një vizitë mbikëqyrëse në ASK më 10 shtator dhe në AI më 11 shtator, një deputet nga VMRO-DPMNE-ja përdori gjuhë nxitëse për t'i bërë thirrje prokurorisë të ndërmarrë veprime të forta, duke kritikuar ato që ai i përshkroi si shkelje të qarta ligjore dhe abuzime që tashmë duhet të kishin çuar në akuza dhe duke kërkuar përgjegjësi.[24]

20 Seanca e katërt e Këshillit për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile (4-та седница на Советот за соработка меѓу Владата и граѓанското општество), Këshilli për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile, 25 shtator 2025, https://www.nvosorabotka.gov.mk/?q=node/1052

21 Agjencia e Sigurisë Kombëtare ka raportuar në Prokurori për sjellje të paligjshme dhe joprofesionale nga një ish-drejtor dhe një grup punonjësish.(АНБ пријавила кај Обвинителството незаконско и непрофесионално постапување на ексдиректор и група вработени), 360 Stepeni, 29 gusht 2025, https://360stepeni.mk/anb-prijavila-kaj-obvinitelstvoto-nezakonsko-i-neprofesionalno-postapuvane-na-eksdirektor-i-grupa-vraboteni/

22 Seanca e Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Punës së Agjencisë së Sigurisë Kombëtare dhe Agjencisë së Inteligjencës është shtyrë. (Одложена седницата на собраниската Комисија за надзор над работата на АНБ и Агенцијата за разузнавање), 360 Stepeni, 5 shtator 2025, https://360stepeni.mk/odlozhena-sednitsata-na-sobraniskata-komisija-za-nadzor-nad-rabotata-na-anb-i-agentsijata-za-razuznavane/

23 Petrovska hyri në ASK me rreth tridhjetë pyetje, Prenxhov pret të shohë se kush është përgjuar (Петровска во АНБ влезе со триесетина прашања, Пренџов очекува да види кој сè бил прислушуван), 360 Stepeni, 10 shtator 2025, https://360stepeni.mk/petrovska-vo-anb-vleze-so-triesetina-prashana-prendhov-ochekuva-da-vidi-koj-se-bil-prislushuvan/

24 Deputeti Kovaçki i bëri thirrje Prokurorisë të "godasë veten" nëse nuk reagon ndaj ASK (Пратеникот Ковачки повика Обвинителството да се „издига на клоци" ако не реагира за АНБ), 360 Stepeni, 11 shtator 2025, https://360stepeni.mk/pratenikot-kovachki-povika-obvinitelstvoto-da-se-izdiga-na-klotsi-ako-ne-reagira-za-anb/

Reforma e Administratës Publike

Në korrik 2025, në Agjencinë e Administratës (AA) u zbulua një skemë e organizuar korrupsioni: tre punonjës (kreu i IT, një bashkëpunëtor për administrimin e provimeve dhe Sekretari i Përgjithshëm) organizuan provime për zyrtarët administrativë në këmbim të ryshfetit, duke u mundësuar kandidatëve të pakualifikuar të marrin rezultatet më të larta dhe të sigurojnë punësim. Rasti u zbulua pas një hetimi të gjatë që përfshinte masa të veçanta dhe dokumentet konfirmuan se praktika kishte ekzistuar për një periudhë të gjatë dhe nën qeveri të ndryshme. Të tre hynë në marrëveshje me prokurorinë, pranuan fajësinë e tyre, morën dënime të pezulluara, dhe njëri prej tyre u ndalua të mbante poste publike për pesë vjet. Punësimi i tyre u ndërpre në gusht 2024.[25]

Në korrik, Sindikata për të Punësuarit në Administratën Shtetërore (SPASH) dhe organizata sindikale brenda AA-së kërkuan një rritje të pagave prej 30% për punonjësit në Sektorin e Përzgjedhjes së Kandidatëve, duke paralajmëruar ndërprerje të punës nëse kërkesa e tyre nuk plotësohet. Ata theksuan se stafi punon nën presion të konsiderueshëm dhe afate të ngushta, gjë që ndikon negativisht në shëndetin dhe jetën e tyre private. Gati 80% e punonjësve fitojnë nën pagën mesatare kombëtare, qarkullimi i stafit po rritet në mënyrë të vazhdueshme dhe ndryshe nga institucionet e tjera, AA nuk miraton fonde për ngritje në detyrë ose punësime të reja, duke i lënë punonjësit të nënvlerësuar, të mbingarkuar dhe të rraskapitur.[26]

Një vit pasi premtoi një ulje prej 10% në sektorin publik të Maqedonisë së Veriut, qeveria në vend të kësaj po zgjeron punësimin nëpër ministri dhe agjenci përpara zgjedhjeve lokale të tetorit. Zyrtarët e përshkruajnë këtë si pjesë të një plani të personelit, por opozita dhe sindikatat akuzojnë VMRO-DPMNE për mbushjen e vendeve të punës me lojalistë për të rritur mbështetjen elektorale. Numri i saktë i punonjësve publikë është i paqartë, pasi qeveria ka vonuar publikimin e raportit të punësimit të këtij viti.[27]

Më 10 korrik, Kuvendi miratoi tre ligje kryesore të RAP: Ligjin për nëpunësit administrativë, Ligjin për punonjësit e sektorit publik dhe Ligjin për zhvillimin profesional të nëpunësve administrativë. Ligjet synojnë të sigurojnë punësim dhe promovim të bazuar në merita dhe kompetenca në administratën publike përmes një sistemi digjital transparent, kushte të përmirësuara të punës për profesionistët e TI-së, stimuj për talentet e reja, trajnim të detyrueshëm nëpërmjet Akademisë, mentorim të strukturuar dhe kritere të qarta për avancim dhe llogaridhënie, të gjitha nën kontroll të centralizuar dhe mbikëqyrje institucionale.[28]

Më 2 shtator, Qeveria miratoi dokumentet e mëposhtme: Programi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (MFP) për periudhën 2025-2028[29], së bashku me Planin e saj të Veprimit për vitin 2025,[30] dhe Raportin e Monitorimit për Zbatimin e Programit të Reformës së MFP për periudhën janar-dhjetor 2024.[31]

25 "Fabrika e kopjuesve në Agjencinë e Administratës (Фабрика за препишувачи во Агенцијата за администрација)," Sloboden Pecat, 31 korrik 2025, https://www.slobodenpecat.mk/fabrika-za-prepishuvachi-vo-agencijata-za-administracija/.

26 "SPASH kërkon rritje të pagave të punonjësve që zgjedhin kandidatë në Agjencinë e Administrimit (УПОЗ бара зголемување на платите на вработените што селектираат кандидати во Агенцијата за администрација)," 360 Stepeni, 10 korrik 2025, https://360stepeni.mk/upoz-bara-zgolemuvane-na-platite-na-vrabotenite-shto-selektiraat-kandidati-vo-agentsijata-za-administratsija/.

27 Sinisa Jakov Marushiq, "Pretendimi dhe kundërpretendimi në Maqedoninë e Veriut mbi punësimin publik para zgjedhjeve», (Claim and counter-claim in North Macedonia over pre-election public hiring), BalkanInsight, 29 korrik 2025, https://balkaninsight.com/2025/07/29/claim-and-counter-claim-in-north-macedonia-over-pre-election-public-hiring/.

28 "Minçev: Ne kemi bërë një hap historik në reformën e administratës publike me miratimin e tre ligjeve kryesore (Минчев: Направивме историски исчекор во реформата на јавната администрација со усвојување на три клучни закони)," Faqja zyrtare e Ministrisë së Administratës Publike, 11 korrik 2025, https://mja.gov.mk/mk-MK/odnosi-so-javnost/soopstenija/mincev-napravivme-istoriski-iscekor-vo-reformata-na-javnata-administracija-so-usvojuvanje-na-tri-klucni-zakoni.

29 "Programi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike për periudhën 2025-2028 (Програма за реформа на управувањето со јавни финансии за периодот 2025 – 2028 година)," Faqja zyrtare e Ministrisë së Financave, korrik 2025, https://portal.mdt.gov.mk/post-body-files/upravuvanje-so-javnite-finansii-file-VNVH.pdf.

30 "Plani i Veprimit për Zbatimin e Programit të Reformës së Menaxhimit të Financave Publike për vitin 2025 (Акциски план за спроведување на Програмата за реформа на управувањето со јавни финансии за 2025 година)," Faqja zyrtare e Ministrisë së Financave, 2025, https://portal.mdt.gov.mk/post-body-files/upravuvanje-so-javnite-finansii-file-3giW.pdf.

31 "Raporti Vjetor i Monitorimit për Zbatimin e Programit të Reformës së Menaxhimit të Financave Publike për periudhën janar-dhjetor 2024 (Годишен извештај за следење на спроведувањето на Програмата за реформа на управувањето со јавни финансии за периодот јануари - декември 2024 година)," Faqja zyrtare e internetit e Ministrisë së Financave, korrik 2025, https://portal.mdt.gov.mk/post-body-files/upravuvanje-so-javnite-finansii-file-jTkV.pdf.

Më 18 shtator 2025, Ministri i Administratës Publike dhe përfaqësuesit e Mbështetjes për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit/Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (SIGMA/OECD) zhvilluan një takim pune për të përgatitur Ligjin për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore (LOPOASH). Është gjithashtu në proces përgatitja e Ligjit për Shërbimin e Lartë Drejtues dhe Ligjit për Sistemin e Pagave.[32]

Ministria e Administratës Publike (MAP) ka nisur një program të zhvillimit profesional për nëpunësit civilë në përputhje me Ligjin e fundit për Zhvillimin Profesional. Në fazën e tij të parë, do të përfshihen 1,000 punonjës, me më shumë se 500 tashmë duke filluar trajnimin e standardizuar në Shkup. Programi mbështetet nga partnerë ndërkombëtarë, duke përfshirë Shkollën Rajonale të Administratës Publike (ReSPA), Qendrën e Ekselencës në Financa (CEF), Agjencinë Franceze për Aftësim Profesional, Institutin Vita dhe Fakultetin e Ekonomisë. Ajo do të vazhdojë në muajt e ardhshëm me seanca rajonale trajnimi në të gjithë vendin.[33]

MAP dhe Ambasada e Francës kanë nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit për një projekt që synon modernizimin e institucioneve dhe ndërtimin e një administrate publike profesionale dhe të besueshme. Projekti "Forcimi i Kapaciteteve dhe Profesionalizimi i Administratës", i realizuar në partneritet me Institutin Kombëtar të Administratës Publike të Francës (INSP), Drejtorinë e Përgjithshme për Administratën dhe Shërbimin Civil (DGAFP), si dhe Qendrën për Menaxhimin e Ndryshimeve (QMN), synon të krijojë një Akademi për trajnimin dhe zhvillimin profesional të zyrtarëve administrativë dhe për të rritur profesionalizimin përmes shkëmbimit të përvojave dhe programeve inovative të trajnimit.[34]

32 "Ministria e Administratës Publike ka filluar ciklin e parë të trajnimeve të përgjithshme për nëpunësit administrativë (Министерството за јавна администрација го започна првиот циклус на генерички обуки за административни службеници)," Faqja zyrtare e Ministrisë së Administratës Publike, 18 shtator 2025, https://mja.gov.mk/mk-MK/odnosi-so-javnost/soopstenija/ministerstvoto-za-javna-administracija-go-zapocna-prviot-ciklus-na-genericki-obuki-za-administrativni-sluzbenici.

33 Ibid.

34 "Ministria e Administratës Publike dhe Ambasada e Francës në Republikën e Maqedonisë me një projekt të përbashkët për forcimin e kapaciteteve dhe profesionalizimin e administratës publike (Министерството за јавна администрација и Амбасадата на Франција во Република Македонија со заеднички проект за јакнење на капацитетите и професионализација на јавната администрација)," Faqja zyrtare e Ministrisë për Administratë Publike, 19 shtator 2025, https://bit.ly/4nNplvN.

Kapitulli 23



Funksionimi i gjyqësorit

Organet e menaxhimit

Në seancën e 28-të më 30 shtator 2025, Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi vendim për ndërprerjen e funksionit të Kryetarit të Këshillit për shkak të skadimit të mandatit më 1 tetor 2025. Këshilli vendosi gjithashtu të shtyjë zgjedhjen e një Kryetari të ri deri në përfundimin e zgjedhjeve lokale në vazhdim. Derisa të zgjidhet një Kryetar i ri, Këshilli do të kryesohet nga Zëvendës kryetari, mandati i të cilit mbetet në fuqi.[35]

Pavarësia dhe paanshmëria

Në seancën e 253-të të datës 28 korrik 2025, Këshilli i Buxhetit Gjyqësor shqyrtoi edhe një herë çështjen e mosdhënies së pëlqimit për punësim me afat të caktuar nga Ministria e Financave. Duke marrë parasysh ndikimin negativ në punën gjyqësore për shkak të mungesës së stafit, anëtarët e Këshillit ranë dakord të dërgojnë një shkresë të dytë duke kërkuar që Ministria e Financave të miratojë punësimin me afat të caktuar në gjykata.[36] Më pas, në seancën e 534-të, Këshilli i Buxhetit Gjyqësor shqyrtoi një njoftim nga Ministria e Financave ku thuhej se burimet financiare nuk ishin alokuar për punësimin e kërkuar me afat të caktuar në gjyqësor.[37]

Llogaridhënia

Në seancën e tij të 526-të, Këshilli Gjyqësor shqyrtoi raportet në lidhje me situatat e përcaktuara dhe faktike pas paraqitjes së kërkesave për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarëve. Ka vendosur ndërprerjen e procedurës në pesë lëndë që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e gjyqtarëve, ndërkohë që në një lëndë nuk është marrë asnjë vendim. Për më tepër, Këshilli themeloi Komisione të Relatorëve për të shqyrtuar kërkesat e paraqitura me qëllim përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave.[38]

Profesionalizmi dhe kompetenca

Në seancën e tij të 525-të, Këshilli Gjyqësor caktoi Kryetarët e Përkohshëm të Gjykatës për Gostivar, Dibër, Shën Nikollë dhe Shkup për të shërbyer derisa të zgjidhen Kryetarë të rinj të Gjykatës.[39] Në seancën e tij të 526-të, Këshilli Gjyqësor emëroi një kryetar të ri të Gjykatës Themelore Ohër.[40]

Në seancën e 26-të më 4 korrik 2025, Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi vendimet për emërimin e prokurorit publik si Kryeprokuror Publik i Prokurorisë Themelore Publike në Kërçovë, dhe një prokuror tjetër publik si Kryeprokuror Publik i Prokurorisë Themelore Publike në Strugë.[41]

35 Njoftim nga seanca e 28-të (Соопштение од одржана 28-ма седница), Këshilli i Prokurorëve Publikë, 30 shtator 2025, https://sjorm.gov.mk/soopshtenie-od-odrzhana-28-ma-sednica/

36 Njoftim nga seanca 253-të (Соопштение од одржана 253-та седница), Këshilli Buxhetor Gjyqësor, 28 korrik 2025, https://bit.ly/4nIBTVa

37 Njoftim nga seanca e 254-të (Соопштение од одржана 254-та седница), Këshilli Buxhetor Gjyqësor, 27 gusht 2025,

38 Njoftim nga seanca e 526-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë (Соопштение од 526-та седница на Судскиот совет на РСМ), Këshilli Gjyqësor, 23 korrik 2025, https://bit.ly/4oidCoM

39 Njoftim nga seanca e 525-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë (Соопштение од 525-та седница на Судскиот совет на РСМ), Këshilli Gjyqësor, 3 korrik 2025, https://bit.ly/43eMRJR

40 Njoftim nga seanca e 526-të e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë (Соопштение од 526-та седница на Судскиот совет на РСМ), Këshilli Gjyqësor, 23 korrik 2025, https://bit.ly/474JeHr

41 Njoftim nga seanca e 26-të (Соопштение од одржана 26-та седница), Këshilli i Prokurorëve Publikë, 4 korrik 2025, https://sjorm.gov.mk/soopshtenie-od-odrzhana-26-ta-sednica/

Më pas, në seancën e 27-të më 16 korrik 2025, Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi një vendim për emërimin e dy prokurorëve publikë në Prokurorinë e Lartë Publike në Shkup, dhe gjithashtu miratoi emërimin e dy prokurorëve publikë në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (PTHPNKOK).[42]

Cilësia e drejtësisë

Në korrik, Grupi Bluprint për Reformë në Gjyqësor shprehu shqetësimin për vendimin e Bordit Drejtues të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, të miratuar në seancën e tij të 235-të më 24 qershor 2025, i cili emëroi Këshilltarin e Posaçëm të Ministrit të Drejtësisë si anëtar të Këshillit të Programit të Akademisë. Sipas grupit, informacioni i disponueshëm publikisht tregon se anëtari i emëruar i Këshillit të Programit shërben si Këshilltar i Posaçëm i Ministrit të Drejtësisë. Ky pozicion nuk kualifikohet si nëpunës civil menaxherial sipas Ligjit për Nëpunësit Administrativë, por përkundrazi përbën një angazhim me afat të caktuar sipas Ligjit për Punonjësit e Sektorit Publik.[43]

Pas kësaj, në seancën e 236-të, Bordi Drejtues i Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë shqyrtoi vendimin e miratuar më 24 qershor 2025, në lidhje me emërimin e një anëtari të ri në Këshillin Programor të Akademisë. Pas shqyrtimit, Bordi udhëzoi Akademinë t'i drejtohet zyrtarisht dhe të konsultohet me Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për të përcaktuar nëse emërimi është në përputhje me ligjin. Në të njëjtën seancë, një gjyqtar i Gjykatës Themelore Civile Shkup u emërua si zëvendës anëtar i Bordit Drejtues të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, pas një nominimi të paraqitur nga Shoqata e Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Më pas, Akademia i dërgoi një letër Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me Planin e Rritjes së Ballkanit Perëndimor 2024-2027, në të cilin Akademia përfshihet në reformën 5.2.1, konkretisht hapi që deklaron se pozicionet vakante për gjyqtarë dhe prokurorë duhet të plotësohen rregullisht bazuar në parashikimet e Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë Publike të Shtetit pas zbatimit të Strategjive të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Gjykatat dhe Prokuroritë (planifikuar për në dhjetor 2024 dhe përsëri në dhjetor 2026). Për më tepër, Akademia iu referua një rregulloreje për zbatimin dhe kontrollin e Instrumentit të Reformës dhe Rritjes së Ballkanit Perëndimor, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut më 20 maj 2025, dhe paraqiti një tabelë në lidhje me Planin e Rritjes në Ministrinë e Drejtësisë. Akademia gjithashtu paraqiti një kërkesë për një ndryshim në Ligjin për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë në Ministrinë e Drejtësisë.[44]

Në seancën e tij të 237-të, Bordi Drejtues i Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë miratoi, me kërkesë të anëtarit të kontestuar, përfundimin e mandatit të tij në Këshillin e Programit. Pas kësaj, Akademisë iu kërkua të paraqesë një kërkesë në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për emërimin e një anëtari të ri të Këshillit të Programit brenda 30 ditëve nga data e vendimit për përfundimin e mandatit.[45]

Në seancën e tij të 239-të, Bordi Drejtues i Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë u informua nga Drejtori i Akademisë për ecurinë në zbatimin e hapave të Agjendës së Reformës 2024-2028, konkretisht në lidhje me plotësimin e pozicioneve vakante të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë. Pas këtij përditësimi,

42 Njoftim nga seanca e 27-të (Соопштение од одржана 27-ма седница), Këshilli i Prokurorëve Publikë, 16 korrik 2025, https://sjorm.gov.mk/soopshtenie-od-odrzhana-27-ma-sednica/

43 Njoftimi (Соопштение) Grupi Bluprint për Reformë në Gjyqësor, 4 korrik 2025, https://bit.ly/3IMbNBD

44 Raport nga seanca e 236-të e Bordit Drejtues të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë (Известување од одржана 236-та седница на Управниот одбор на Академија за судии и јавни обвинители), Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, 17 korrik 2025, https://bit.ly/477HgWS

45 Raport nga seanca e 237-të e Bordit Drejtues të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë (Известување од одржана 237-ма седница на Управниот одбор на Академија за судии и јавни обвинители), Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, 9 gusht 2025, https://bit.ly/4ogENjI

Bordi Drejtues udhëzoi Akademinë t'i drejtohet Ministrisë së Financave, përmes Këshillit të Buxhetit Gjyqësor, për të kërkuar konfirmimin nëse janë ndarë fonde për pranimin e 130 studentëve nga brezi i nëntë i Akademisë në vitin 2026.[46]

Efikasiteti

Prokuroria Themelore Publike në Manastir krijoi një qendër hetimi që synonte forcimin e kapaciteteve të saj hetimore. Fillimisht, dy hetues janë punësuar për të filluar punën. Këto qendra hetimore tashmë funksionojnë në prokuroritë në Shkup, Tetovë, Kumanovë dhe në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit.[47]

46 Raport nga seanca e 239-të e Bordit Drejtues të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë (Известување од одржана 239-та седница на Управниот одбор на Академија за судии и јавни обвинители), Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, 18 shtator 2025, https://bit.ly/4ohfX3p

47 Prokuroria e Manastirit ka fituar një qendër hetimore. (Битолското обвинителство доби истражен центар), 360 Stepeni, 31 korrik 2025, https://360stepeni.mk/bitolskoto-obvinitelstvo-dobi-istrazhen-tsentar/

Lufta Kundër Korrupsionit

Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO) publikoi një raport të ri në kuadër të Raundit të Pestë të Vlerësimit për Maqedoninë e Veriut, duke marrë parasysh përparimin e arritur nga vendi në zbatimin e rekomandimeve të tij për të parandaluar korrupsionin brenda funksioneve të larta ekzekutive të qeverisë qendrore dhe policisë. Raporti arrin në përfundimin se Maqedonia e Veriut ka zbatuar në mënyrë të kënaqshme 17 nga 23 rekomandimet, ndërsa pjesa tjetër mbetet pjesërisht e zbatuar. Hapat e ndërmarra për të rritur transparencën dhe promovuar integritetin në lidhje me personat e besuar me funksione të larta ekzekutive, si rregullorja e re e punës së qeverisë dhe krijimi i një baze elektronike për regjistrimin dhe verifikimin e deklarimeve të pasurisë së zyrtarëve publikë të zgjedhur dhe të emëruar, u mirëpritën në raport.[48]

Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Hetimi i Kryetares së KSHPK-së për dyshimet se ka zbuluar sekrete zyrtare në rastin "Aditiv",[49] përfundoi me aktakuzë kundër saj për atë vepër penale.[50] Për më tepër, hetimi zbuloi se ajo kishte bërë që një auditor nga Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) të jepte një provim në vend të saj, duke i mundësuar asaj të merrte certifikatën e sigurisë për qasje në informacione të klasifikuara si sekret shtetëror.[51] Kjo shkaktoi një padi tjetër kundër saj për falsifikim kompjuterik, ndërsa ESHR e largoi revizorin nga kryerja e revizioneve dhe revokoi certifikatën e tij të sigurisë.[52] Menjëherë pas kësaj, Kryetarja e KSHPK-së dha dorëheqjen nga posti i saj dhe Kuvendi konfirmoi dorëheqjen e saj.[53] Ajo paraqiti një kërkesë në ESHR për t'u kthyer në pozicionin e saj të mëparshëm si asistente e Revizorit të Përgjithshëm të Shtetit,[54] ndërsa në fund të shtatorit, filloi gjykimi kundër saj për krimet e lartpërmendura.[55]

Në fillim të gushtit, Kuvendi publikoi një vendim për të lëshuar një shpallje publike për zgjedhjen e një kryetari të ri të KSHPK-së, pas së cilës u formua një komision për të zgjedhur kandidatët për atë pozicion.[56] Trembëdhjetë kandidatë aplikuan,[57] megjithatë, Kuvendi pezulloi përzgjedhjen për shkak të zgjedhjeve lokale

48 'Maqedonia e Veriut: GRECO mirëpret përparimin në reformat kundër korrupsionit në qeverinë qendrore dhe policinë dhe përfundon procedurën e pajtueshmërisë ', (North Macedonia: GRECO welcomes progress in anti-corruption reforms in central government and the police and ends compliance procedure), Faqja zyrtare e Këshillit të Evropës, 9 korrik 2025, https://www.coe.int/en/web/portal/-/north-macedonia-greco-welcomes-progress-in-anti-corruption-reforms-in-central-government-and-the-police-and-ends-compliance-procedure.

49 Komisioni antikorrupsion, i nënshkruar nga Dimitrovska, hedh poshtë dy raporte në lidhje me lëndën "Aditiv" (Антикорупциска, со потпис на Димитровска, отфрлила две пријави поврзани со случајот "Адитив"), Telma TV, 25 prill 2025, https://telma.com.mk/2025/04/25/antikorupczиska-so-potpis-na-dimitrovska-otfrlila-dve-prijavi-povrzani-so-sluchajot-aditiv/.

50 'Aktakuzë kundër Dimitrovskës nga KSHPK – ajo zbuloi sekrete zyrtare përmes Viber, dhe provimin për të marrë certifikatëa ka kaluar dikush tjetër për te (Обвинение за Димитровска од ДКСК – оддавала службени тајни преку Вибер, а сертификатот за тајност ѝ го полагал друг)', 360 Stepeni, 18 korrik 2025, https://360stepeni.mk/obvinenie-za-dimitrovska-od-dksk-oddavala-sluzhbeni-tajni-preku-viber-a-sertifikatot-za-tajnost-i-go-polagal-drug/.

51 'Një revizore kaloi testin për Kryetaren e KSHPK-së në mënyrë që ajo të mund të lexonte sekretet shtetërore – aktakuzë dhe akuza të reja kundër Tatjana Dimitrovskës (Ревизор ѝ го положил тестот на претседателката на ДКСК за таа да може да чита државни тајни – обвинение и нови дела за Татјана Димитровска)', Sloboden Pecat, 18 korrik 2025, https://www.slobodenpecat.mk/revizor-i-go-polozhil-testot-na-vcpretsedatelkata-na-dksk-za-taa-da-mozhe-da-chita-drzhavni-tajni-obvinenie-i-novi-dela-za-tatjana-dimitrovska/.

52 'Revizori që kaloi testin e "sekreteve shtetërore" të Tatjana Dimitrovskës është pezulluar nga kryerja e revizioneve (Ревизорот што ѝ го положил тестот на Татјана Димитровска за „државна тајна" е исклучен од ревизиите)', Sloboden Pecat, 23 korrik 2025, https://www.slobodenpecat.mk/revizorot-shto-%D1%9D-go-polozhil-testot-na-tatjana-dimitrovska-za-drzhavna-tajna-e-iskluchen-od-reviziite/.

53 'Kuvendi konfirmoi dorëheqjen e Kryetares së KSHPK-së, Tatjana Dimitrovska (Собранието ја констатира оставката на претседателката на ДКСК, Татјана Димитровска)', 360 Stepeni, 29 korrik 2025, https://360stepeni.mk/sobranieto-ja-konstatira-ostavkata-na-pretsedatelkata-na-dksk-tatjana-dimitrovska/.

54 'Ish-anëtarja e Komisionit Kundër Korrupsionit Dimitrovska kthehet në Entin Shtetëror të Revizionit (Екс-антикорупционерката Димитровска се враќа во Државниот завод за ревизија)', Libertas, 30 korrik 2025, https://libertas.mk/eks-antikorupcionerkata-dimitrovska-se-vra-a-vo-drzhavniot-zavod-za-revizi-a/.

55 'Ka filluar gjykimi kundër ish-Kryetares së Komisionit Kundër Korrupsionit, Tatjana Dimitrovska (Почна судењето против поранешната претседателка на Антикорупциска, Татјана Димитровска)', 360 Stepeni, 30 shtator 2025, https://360stepeni.mk/pochna-sudeneto-protiv-poraneshnata-pretsedatelka-na-antikoruptsiska-tatjana-dimitrovska/.

56 'Është formuar një komision për përzgjedhjen e kandidatëve për kryetar të KSHPK-së (Формирана комисијата за селекција на кандидатите за претседател на ДКСК)', Nova Makedonija, 13 gusht 2025, https://novamakedonija.com.mk/makedonija/formirana-komisijata-za-selekcija-na-kandidatite-za-pretsedatel-na-dksk/.

57 '13 kandidatë aplikuan për postin e kryetarit të KSHPK-së, këta janë emrat (За претседател на ДКСК се пријавиле 13 кандидати, еве ги имињата)', 360 Stepeni, 18 gusht 2025, https://360stepeni.mk/za-pretsedatel-na-dksk-se-prijavile-13-kandidati-eve-gi-iminata/.

në pritje në vend.[58] Në mes të gushtit, KSHPK-ja zgjodhi një zëvendëskryetar të ri nga radhët e anëtarëve të saj, në përputhje me parimin e rotacionit.[59]

Në mes të shtatorit, u mbajt një takim konsultativ me organizatat e shoqërisë civile (OSHC) si pjesë e përgatitjes së Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2026–2030. Gjegjësisht, KSHPK u takua me përfaqësues të Platformës së Organizatave të Shoqërisë Civile që luftojnë kundër Korrupsionit për të shqyrtuar dhe diskutuar Vlerësimin e përgatitur të Rrezikut të Korrupsionit me qëllim të përgatitjes së Strategjisë dhe metodologjisë për përgatitjen e saj.[60]

Gjatë gjithë periudhës raportuese, KSHPK zhvilloi aktivitete përgatitore përpara zgjedhjeve lokale në pritje. Janë zhvilluar takime pune me KSHZ[61] dhe Prokurorinë Publike[62]. U nënshkrua një memorandum bashkëpunimi me KSHZ-në dhe ESHR-në për të forcuar angazhimin e tyre për bashkëpunim të drejtpërdrejtë, koordinim dhe ndihmë të ndërsjellë në zbatimin e dispozitave ligjore për financimin e fushatave zgjedhore, shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave dhe veprimin në kohë pas indentifikimit potencial të parregullsive zgjedhore.[63] KSHPK gjithashtu lëshoi një njoftim publik për të informuar të gjitha institucionet shtetërore, partitë politike, pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, si dhe publikun e gjerë për mundësitë ligjore për përdorimin e fondeve buxhetore në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe Kodin Zgjedhor.[64] Ajo gjithashtu njoftoi publikun se, në zbatim të detyrimit ligjor të të gjitha fondeve publike, ndërmarrjeve publike dhe të gjithë personave të tjerë juridikë me kapital shtetëror, ata janë të detyruar të paraqesin të dhëna në KSHPK për të gjitha automjetet zyrtare në që i kanë në dispozicion. Megjithatë, vetëm 42% dorëzuan të dhëna të tilla.[65]

Zyra e Prokurorisë Publike

Pas një hetimi të iniciuar nga PTHPNKOK, u ngrit një aktakuzë kundër 36 individëve (mjekë, avokatë dhe persona të tjerë zyrtarë) të organizuar në dy grupe kriminale që ndërmjetësuan dhe mundësuan në mënyrë të paligjshme fitimin e të drejtave për pensionin e kujdesit dhe të aftësisë së kufizuar të të tjerëve, në këmbim të parave gjatë dy viteve të fundit. Lënda, e titulluar "Sindrom", zbuloi dyshime të arsyeshme për disa vepra penale të kryera, përkatësisht: shoqërimi kriminal, pranimi dhe dhënia e ryshfetit dhe marrja e shpërblimit për ndikim të paligjshëm. Deri më tani, 13 të pandehur kanë lidhur marrëveshje për pranimin e fajësisë me prokurorinë dhe, bazuar në këto, Gjykata Themelore Penale Shkup ka shpallur disa vendime. Për pjesën tjetër, prokuroria publike i ka propozuar gjykatës që të vazhdohen masat e sigurisë tashmë të vendosura ndaj tyre.[66]

58 'Procedura për zgjedhjen e kryetarit të KSHPK-së është pezulluar (Запрена постапката за избор на претседател на ДКСК)', Faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 14 gusht 2025, https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-zaprena-postapkata-za-izbor-na-pretsedatel-na-dksk.nspx.

59 'Cveta Ristovska, profesori i Bojan Hristovskit dhe një duzinë studentësh që kanë mbaruar fakultetin privat në vetëm një vit, do të udhëheqin Komisionin Kundër Korrupsionit gjatë zgjedhjeve (Цвета Ристовска, професорката на Бојан Христовски и на дузина академски граѓани што го протрчаа приватниот факултет за една година, ќе ја води Антикорупциската комисија за изборите)', Sdk.mk, 15 gusht 2025, https://bit.ly/4gR36SU.

60 'U mbajt një takim pune midis Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Platformës së Organizatave të Shoqërisë Civile që luftojnë kundër Korrupsionit për të përgatitur Strategjinë e re Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2026-2030 (Одржан работен состанок помеѓу Државната комисија за спречување на корупцијата и Платформата на граѓански организации за борба против корупција за подготовка на новата Национална стратегија за спречување на корупцијата и судирот на интереси 2026-2030)', Uebfaqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 18 shtator 2025, https://bit.ly/3IKIO12.

61 'Bashkëpunimi drejt promovimit të integritetit të procesit zgjedhor (Соработка во насока на унапредување на интегритетот во изборниот процес)', Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 16 korrik 2025, https://bit.ly/4h1Qmt2.

62 'Takimi i punës i KSHPK-së dhe Prokurorisë Publike para zgjedhjeve lokale të vitit 2025 (Работна средба на ДКСК и Јавното обвинителство во пресрет на локалните избори 2025)', Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 16 shtator 2025, https://bit.ly/3VTa4xc.

63 'KSHZ, KSHPK dhe ESHR nënshkruan një memorandum bashkëpunimi përpara zgjedhjeve lokale (ДИК, ДКСК и ДЗР потпишаа меморандум за соработка во пресрет на локалните избори)', 360 Stepeni, 18 shtator 2025, https://360stepeni.mk/dik-dksk-i-dzr-potpishaa-memorandum-za-sorabotka-vo-presret-na-lokalnite-izbori/.

64 'Njoftim (Известување)', Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 11 gusht 2025, https://bit.ly/4mTIDhU.

65 'Vetëm 42% e institucioneve dorëzuan të dhëna për automjetet zyrtare përpara zgjedhjeve lokale të vitit 2025 (Само 42% од институциите доставија податоци за службени возила пред локалните избори 2025)', Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 29 shtator 2025, https://bit.ly/46SSEFQ.

66 'Lënda "Sindrom" – 36 të pandehur dhe 13 marrëveshje për pranimin e fajësisë (Предмет "Синдром" – 36 обвинети и 13 спогодби)', Faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 22 korrik 2025, https://jorm.gov.mk/predmet-sindrom-36-obvineti-i-13-spogodbi/.

Filloi gjykimi i ish-drejtorëve të Klinikës së Radioterapisë dhe Onkologjisë në Shkup, në kuadër të lëndës "Onkologjia 2". Të pandehurit akuzohen për keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar, mashtrim dhe përvetësim në shërbim, për shkaktim të dëmit në buxhet prej mbi 2.2 miliardë denarë duke blerë ilaçe në mënyrë të paligjshme pa pëlqimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Gjatë seancës në 12 shtator, të dy të pandehurit deklaruan se nuk ndjehen fajtorë dhe procedurat gjyqësore janë në vazhdim.[67]

Në rastin kundër ish-drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Programe Arsimore Evropiane dhe Lëvizshmëri, Gjykata Themelore Penale Shkup e shpalli atë fajtore për shpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar dhe e dënoi me dy vjet burg. U përcaktua se ajo ka punuar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Ligjin për Themelimin e Agjencisë Kombëtare për Programe Arsimore Evropiane dhe Lëvizshmëri gjatë lidhjes së kontratave me bashkëpunëtorë, ekspertë dhe trajnerë, pasi ajo nuk shpalli konkurs publik dhe diskriminoi kandidatët e mundshëm, duke u dhënë përparësi disa individëve, dhe veproi në kundërshtim me parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit.[68]

Përveç lëndëve të lartpërmendura, u ngritën edhe kallëzime penale për: shpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar kundër ish-kryetarit të përkohshëm të Këshillit për Promovimin dhe Mbikëqyrjen e Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut[69] dhe kundër kryetarit aktual të Komunës së Strugës,[70] si dhe kundër një ish-drejtori të Burgut të Shkupit dhe dy oficerëve të policisë së burgut;[71] marrja e një shpërblimi për ndikim të paligjshëm dhe pranimi i ryshfetit nga gjashtë oficerë policie dhe dy persona të tjerë;[72] pranimi i ryshfetit nga drejtori i një institucioni publik shëndetësor[73] dhe nga një mjek nga një spital tjetër;[74] dhe shoqërimi kriminal, shpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar, dhe dhënia dhe pranimi i ryshfetit nga pesëmbëdhjetë persona, ndër të cilët janë drejtori i një dege të Ndërmarrjes Publike "Pyjet Kombëtare", shefi i policisë së Dellçevës dhe disa oficerë.[75]

67 'Ish-drejtorët e Onkologjisë nuk ndjehen fajtorë për punë neglizhente dhe krime financiare në klinikë (Ексдиректорите на Онкологија не се чувствуваат виновни за несовесно работење и за финансиски криминал на клиниката)', 360 Stepeni, 12 shtator 2025, https://360stepeni.mk/eksdirektorite-na-onkologija-ne-se-chuvstvuvaat-vinovni-za-nesovesno-rabotene-i-za-finansiski-kriminal-na-klinikata/.

68 'Ish-drejtoresha e Erasmus+ Lidija Dimova u dënua me dy vjet burg për shpërdorim të pozitës zyrtare (Ексдиректорката на „Еразмус+", Лидија Димова, осудена на две години затвор за злоупотреба на службената положба)', 360 Stepeni, 18 shtator 2025, https://360stepeni.mk/eksdirektorkata-na-erazmus-lidija-dimova-osudena-na-dve-godini-zatvor-za-zloupotreba-na-sluzhbenata-polozhba/.

69 'Aktakuzë për shpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar (Обвинителен предлог за злоупотреба на службена положба и овластување)', Faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 23 korrik 2025, https://jorm.gov.mk/obvinitelen-predlog-za-zloupotreba-na-sluzhbena-polozhba-i-ovlastuvane/.

70 'PTHP Strugë ngriti padi kundër Ramiz Merko për kontratën për ndriçimin e shtratit të lumit Drini i Zi (ОЈО Струга му поднесе обвинение на Рамиз Мерко за договорот за осветлување на коритото на Црн Дрим)', 360 Stepeni, 17 shtator 2025, https://360stepeni.mk/ojo-struga-mu-podnese-obvinenie-na-ramiz-merko-za-dogovorot-za-osvetluvane-na-koritoto-na-tsrn-drim/.

71 'Aktakuzë kundër tetë personave (Обвинителен предлог против осум лица)', Faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 8 korrik 2025, https://jorm.gov.mk/obvinitelen-predlog-protiv-osum-licza/.

72 'Aktakuzë kundër tetë personave (Обвинителен акт против осум лица)', Faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 21 gusht 2025, https://jorm.gov.mk/obvinitelen-akt-protiv-osum-licza/.

73 'Dy persona të akuzuar për krime të lidhura me korrupsionin (Поднесено обвинение за две лица за кривични дела поврзани со корупција)', Faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 4 korrik 2025, https://jorm.gov.mk/podneseno-obvinenie-za-dve-licza-za-krivichni-dela-povrzani-so-korupczija/.

74 'Mjeku në Manastir u kap duke pranuar ryshfet, Ministria e Shëndetësisë dënon incidentin (Докторка во Битола фатена како прима поткуп, Министерството за здравство со осуда за настанот)', 360 Stepeni, 16 korrik 2025, https://360stepeni.mk/doktorka-vo-bitola-fatena-kako-prima-potkup-ministerstvoto-za-zdravstvo-so-osuda-za-nastanot/.

75 'PTHPNKOK me detaje në lidhje me aksionin kundër prerjes së paligjshme - drejtori i "Pyjeve Kombëtare" dhe shefi i policisë janë ndër të dyshuarit (ОЈО ГОКК со детали за акцијата против нелегална сеча на шуми – директор во „Национални шуми" и полициски началник се меѓу осомничените)', 360 Stepeni, 19 shtator 2025, https://360stepeni.mk/ojo-gokk-so-detali-za-aktsijata-protiv-nelegalna-secha-na-shumi-direktor-vo-natsionalni-shumi-i-politsiski-nachalnik-se-megu-osomnichenite/.

Të drejtat themelore

Raporti i vitit 2024 i Departamentit Amerikan të Shtetit për Praktikat e të Drejtave të Njeriut për Maqedoninë e Veriut konstatoi se nuk kishte ndryshime të rëndësishme në situatën e të drejtave të njeriut në vend gjatë vitit. Megjithatë, çështje të rëndësishme të të drejtave të njeriut përfshinin raporte të besueshme të kufizimeve serioze të lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias, duke përfshirë dhunën dhe kërcënimet për dhunë ndaj gazetarëve.[76]

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Gjatë periudhës raportuese, ndodhën disa zhvillime në lidhje me procedurën e zgjedhjeve për një gjyqtar të ri nga Maqedonia e Veriut në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Në korrik, Qeveria e Maqedonisë së Veriut anuloi listën e paraqitur më parë të tre kandidatëve për pozicionin e gjyqtarit në GJEDNJ në Strasburg, duke deklaruar se gjeti që asnjë nga tre kandidatët nuk plotësonin kriteret e kërkuara.[77] Reagime erdhën nga kandidatët e mëparshëm,[78] duke i bërë thirrje qeverisë të shpjegojë pse thirrja u anulua, kur komisioni i mëparshëm kishte vlerësuar aplikantët të pranueshëm, dhe gjithashtu duke zbuluar "sugjerimet miqësore" të marra për të tërhequr kandidaturën e tyre për pozicionin e gjyqtarit.[79] Reagime erdhën edhe nga shoqëria civile,[80] duke kritikuar vendimin si jotransparent dhe ligjërisht të diskutueshëm, duke argumentuar se duke refuzuar listën pa shpjegim dhe duke shpërndarë komisionin e mëparshëm të përzgjedhjes, Qeveria minoi besueshmërinë, pavarësinë dhe drejtësinë e procesit të përzgjedhjes.

Komisioni i ri për përzgjedhjen e kandidatëve u formua më 25 korrik,[81] me mbledhjen e tij të parë të mbajtur më 25 gusht.[82] Në mbledhjen e parë, Komisioni ra dakord që thirrja të zgjaste 30 ditë, dy herë më shumë se më parë, dhe se ata do të kalonin një muaj tjetër për vlerësimin, intervistimin dhe përzgjedhjen e tre kandidatëve. Më 2 shtator, Komisioni pati takimin e dytë për të finalizuar thirrjen për kandidatë, pasi nuk ishte në përbërje të plotë në seancat e mëparshme dhe për këtë arsye shtyu vendimin. Thirrja publike për aplikime u publikua më 4 shtator dhe përsëri më 11 shtator.[83] Intervistat e aplikantëve janë planifikuar të mbahen në tetor, pas afatit 30-ditor.

Në gusht, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut pranoi një ankesë të paraqitur nga Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë, e cila akuzon institucionet komunale dhe kombëtare për dështim në përmbushjen e

76 2024 Raportet e Vendeve mbi Praktikat e të Drejtave të Njeriut: Maqedonia e Veriut (Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, 2025), https://www.state.gov/reports/2024-country-reports-on-human-rights-practices/north-macedonia/.

77 'Qeveria anuloi listën e propozuar të kandidatëve për gjyqtar në Strasburg, duke përcaktuar se Ristoska, Gajdova dhe Apostollski nuk i plotësojnë kërkesat (Владата ја поништи предлог-листата со кандидатите за судија во Стразбур, утврдила дека Ристоска, Гајдова и Апостолски не ги исполнуваат условите)', Sloboden Pecat, 29 korrik 2025, https://www.slobodenpecat.mk/vladata-ja-ponishtccci-predlog-listata-so-kandidatite-za-sudija-vo-strazbur-utvrdila-deka-ristoska-gajdova-i-apostolski-ne-gi-ispolnuvaat-uslovite/.

78 'Ristoska: Qeveria duhet të thotë se cilët kandidatë nuk i plotësojnë kërkesat për Gjykatën e Strasburgut (Ристоска: Владата да каже кои кандидати не ги исполнуваат условите за судот во Стразбур)', Sloboden Pecat, 29 korrik 2025, https://www.slobodenpecat.mk/ristoska-vladata-daccc-kazhe-koi-kandidati-ne-gi-ispolnuvaat-uslovite-za-sudot-vo-strazbur/.

79 'Prokurorja Lenqe Ristoska thotë se ajo u udhëzua të tërhiqej nga kandidatura për Strasburg pasi Qeveria refuzoi të gjithë listën pa arsyetim (Обвинителката Ленче Ристоска вели дека ѝ укажувале да се повлече од кандидатурата за Стразбур, откако Владата без образложение ја отфрли целата листа)', Sakam Da Kazam, 31 korrik 2025, https://sdk.mk/index.php/makedonija/obvinitelkata-lenche-ristoska-veli-deka-ukazhuvale-da-se-povleche-od-kandidatura-ta-za-straz-burotko-vladata-bez-obrazlozhenie-ja-otrli-tselata-lista/.

80 'Vendimi i Qeverisë për të anuluar listën e kandidatëve për gjyqtarë në GJEDNJ është jotransparent dhe ligjërisht i diskutueshëm (Владината одлука за поништување на листата на кандидати за судија во ЕСЧП е нетранспарентна и правно спорна)', Grupi Bluprint për Reformë në Gjyqësor (Блупринт група за реформи во правосудството), 31 korrik 2025, https://bit.ly/4oKNwf2.

81 Një fillim i ri në betejën gjyqësore për Strasburgun (Нов почеток во судската битка за Стразбур), Radio Evropa e Lirë, 6 gusht 2025, https://www.slobodnaevropa.mk/a/sud-strazbur-kandidati-/33495184.html.

82 Thirrja për gjyqtarin e Strasburgut do të publikohet javën tjetër (Огласот за судија во Стразбур ќе биде објавен наредната недела), Telma Tv, 25 gusht 2025, https://telma.com.mk/2025/08/25/oglasot-za-sudija-vo-strazbur-ke-bide-objaven-narednata-nedela/

83 Thirrje publike për përzgjedhjen e kandidatëve gjyqtarë për të përfaqësuar Maqedoninë e Veriut në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Јавен оглас за избор на кандидати за судија на Република Северна Македонија во Европскиот суд за човекови права), Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut , 11 shtator 2025, https://www.pravda.gov.mk/vest/6871.

detyrimeve ligjore për mbrojtjen e të drejtës për një mjedis të shëndetshëm dhe shëndetin publik.[84] Ankesa ka të bëjë me rastin e deponisë toksike komunale në qytetin e Strugës, pasi gjykatat vendore, përfshirë Gjykatën Themelore në Strugë dhe Gjykatën e Apelit në Manastir, e deklaruan veten jo kompetente për të shqyrtuar lëndën e deponisë komunale.[85]

Avokati i Popullit

Në 10 korrik, Kuvendi i Maqedonisë së Veriut votoi vendmin për të lëshuar një thirrje publike për zgjedhjen e një Avokati të Popullit të ri[86], pasi që mandati i atij të kaluarit kishte përfunduar në 12 korrik dhe zyrtarisht u deklarua më 17 korrik nga Kryetari i Kuvendit.[87] Pasuan reagime nga vetë Avokati i Popullit, i cili deklaroi se kishte informuar në mënyrë të përsëritëshme si Kuvendin ashtu edhe qeverinë për nevojën që të nisë në kohë procesi i ri i emërimeve, dhe argumentoi se dështimi i tyre për ta bërë këtë përbën shkelje të ligjit që rregullon zyrën e Avokatit të Popullit.[88]

Për më tepër, Rrjeti për Mbrojtjen nga Diskriminimi i bëri thirrje Kuvendit të bazojë procesin e përzgjedhjes në meritë, pavarësi dhe transparencë dhe të përmbahet nga marrëveshjet partiake, duke siguruar që procesi të jetë gjithëpërfshirës, i hapur dhe në përputhje me standardet kombëtare dhe të BE-së për sundimin e ligjit.[89] Shtatëmbëdhjetë kandidatë aplikuan në thirrje.[90]

Komisioni i Zgjedhjeve dhe Emërimeve në Kuvend mbajti seancë më 31 korrik, ku kandidati nga koalicioni VLEN u propozua si Avokati i ri i Popullit.[91] Rrjeti për Mbrojtjen nga Diskriminimi kritikoi përzgjedhjen si të nxitur politikisht dhe jo transparente, duke paralajmëruar se emërimi i një kandidati të lidhur me partinë minon pavarësinë dhe besueshmërinë e institucionit. Ai i kërkoi Kuvendit të sigurojë një proces të hapur, të bazuar në merita që mbron rolin e paanshëm të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve nga ndikimi politik.[92]

Megjithatë, kandidati i propozuar nuk arriti të sigurojë zgjedhje në Kuvend, pasi nuk ishte në gjendje të siguronte “shumicën e Badinterit” të kërkuar,[93] duke minuar kështu më tej kapacitetin dhe pavarësinë e institucionit. Zyra e Avokatit të Popullit tani funksionon vetëm me dy nënkryetarë për të gjithë vendin.[94]

84 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg do të vendosë mbi lëndën e deponisë në Strugë. (Европскиот суд за човекови права во Стразбур ќе расправа за струшката депонија), AIM - Agjencia Informative Mediatike , 15 gusht 2025, https://bit.ly/43uZnVU

85 ‘Lënda e Maqedonisë së Veriut për deponinë e paligjshme në Strugë arrin në Gjykatën e Strasburgut’, (Case of Struga illegal landfill in North Macedonia goes to Strasbourg Court), Balkan Green Energy News , 11 prill 2025, https://balkangreenenergynews.com/case-of-struga-illegal-landfill-in-north-macedonia-goes-to-strasbourg-court/

86 ‘Seance e 59-të e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut - Vendimi për shpalljen e thirrjes për zgjedhjen e Avokatit të Popullit (59 седница на Собрание на Република Северна Македонија - Одлука за распишување оглас за избор на Народен правобранител)’, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 10 korrik 2025, https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal.nspx?param=6ba3bfae-e0bc-4142-958b-6b94753ca57d.

87 ‘Kuvendi konfirmon ndërprerjen e funksionit së Avokatit të Popullit Naser Ziberi (Собранието констатира престанок на функцијата на Народниот правобранител Насер Зибери)’, 360 Stepeni, 17 korrik 2025, https://360stepeni.mk/sobranieto-konstatira-prestanok-na-funktsijata-na-narodniot-pravobranitel-naser-ziberi/.

88 ‘ Kuvendi ende nuk ka përcaktuar një pasardhës – Avokati i Popullit Naser Ziberi po del në pension (Собранието сè уште не одредило наследник – Народниот правобранител Насер Зибери во пензија)’, TV 21, 15 korrik 2025, https://mk.tv21.tv/sobranieto-se-ushte-ne-odredilo-naslednik-narodniot-pravobranitel-naser-ziberi-vo-penzija/.

89 ‘Rrjeti për Mbrojtjen nga Diskriminimi po kërkon një person të pavarur për Avokatin e Popullit (Мрежата за заштита од дискриминација бара независно лице за Народен правобранител)’, Radio Evropa e Lirë, 25 korrik 2025, https://www.slobodnaevropa.mk/a/33483842.html.

90 ‘Rekord i ri - 17 kandidatë për Avokatin e ri të Popullit (Нов рекорд- 17 кандидати за нов Народен правобранител)’, Telma TV, 30 korrik 2025, https://telma.com.mk/2025/07/30/nov-rekord-17-kandidati-za-nov-naroden-pravobranitel/.

91 ‘Faton Selami propozohet si Avokat i ri i Popullit (Фатон Сељами предложен за нов Народен правобранител)’, Kanal 5, 31 korrik 2025, https://kanal5.com.mk/faton-seljami-predlozhen-za-nov-naroden-pravobranitel/a710693.

92 ‘Rrjeti për Mbrojtjen kundër Diskriminimit: Funksioni i Avokatit të Popullit duhet të mbetet jashtë marrëveshjeve partiake (Мрежа за заштита од дискриминација: Функцијата Народен правобранител мора да остане надвор од партиските договори)’, Radio MOF, 4 gusht 2025, https://www.radiomof.mk/mrezha-za-zashtita-od-diskriminacija-funkcijata-naroden-pravobranitel-mora-da-ostane-nadvor-od-partiskite-dogovori/.

93 Avokati i ‘qytetarëve’ i asgjësuar para zgjedhjeve (Адвокатот на граѓаните десеткуван пред избори)’, Sloboden Pecat, 20 gusht 2025, https://www.slobodenpecat.mk/advokatot-na-gragjanite-desetkuvan-pred-izbori/.

94 ‘Kabineti i Gashit: Është nënshkruar vendimi për thirrje për Avokat të ri të Popullit (Кабинетот на Гаши: Потпишана е одлуката за оглас за нов Народен правобранител)’, 360 Stepeni, 15 korrik 2025, https://360stepeni.mk/kabinetot-na-gashi-potpishana-e-odlukata-za-oglas-za-nov-naroden-pravobranitel/.

Burgu dhe objektet e paraburgimit

Ministria e Drejtësisë publikoi propozimligjin e ri për provën, i cili sjell ndryshime thelbësore që synojnë përmirësimin e drejtësisë, mbrojtjen e viktimave dhe bërjen e shërbimit të provës më efikas.[95]

Gjatë periudhës raportuese, një sërë polemikash kritike vazhduan të nënvizojnë problemet kronike në sistemin e burgjeve të Maqedonisë së Veriut. U ngrit aktakuzë kundër ish-drejtorit dhe shtatë punonjësve të tjerë të burgut të Shutkës për shoqërimin me vetëdije dhe me dashje të të dënuarve në vitin 2024 nga burgu në shtëpitë e tyre ose në vende të tjera për qëllime private, në kundërshtim me rregullat procedurale.[96] Nga ana tjetër, i njëjti burg aktualisht përballet me një çështje tjetër: Gjykata Themelore Penale Shkup i dërgoi një letër të hapur drejtuesve të burgut në lidhje me mos shoqërimin e të dënuarve në seancat e planifikuara, duke çuar në shtyrjen e lëndëve. Drejtori aktual i burgut u përgjigj se institucioni përballet me mungesa të stafit dhe automjeteve, të cilat pengojnë proceset e shoqërimit.[97]

Në burgjet e tjera nuk munguan as incidentet. Në departamentin mashkullor të burgut të Idrizovës, një i dënuar sulmoi një oficer të policisë së burgut,[98] ndërsa në seksionin femëror të burgut, një e dënuar 14-vjeçare u mbajt e mbyllur në një qeli deri në 22 orë në ditë sepse nuk ka objekt të veçantë për vajzat e mitura.[99] Avokati i Popullit hapi një lëndë në lidhje me fëmijën dhe arriti ta transferojë atë në Institucionin Korrektues të Tetovës në Vollkovijë, ku tani ka një ndërtesë të tërë për vete.[100]

Në fillim të vitit shkollor, Avokati i Popullit deklaroi se mësimet në Institucionin Korrektues të Tetovës nuk filluan më 1 shtator. Ai më pas e ngriti çështjen me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, por ata nuk i ishin përgjigjur shqetësimeve të tij.[101]

Sipas Statistikave Vjetore Penale 2024 të Këshillit të Evropës mbi Popullsitë e Burgjeve (SPACE I), mbipopullimi në burgje mbetet një sfidë kritike në një të tretën e administratave të burgjeve evropiane, ku përgjithësisht, numri i të burgosurve për 100 vende të disponueshme u rrit nga 93.5 në 94.9 nga 31 janari 2023 deri më 31 janar 2024, ndërsa Maqedonia e Veriut raportoi mbipopullim të moderuar.[102]

Administrata për Zbatimin e Sanksioneve nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me Ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave, për të vendosur bashkëpunim midis institucioneve për sigurimin e tokës bujqësore shtetërore për kryerjen e aktiviteteve bujqësore nga personat e dënuar, si një hap i rëndësishëm në procesin e riintegrimit dhe trajnimit profesional, duke u mundësuar atyre të fitojnë aftësi praktike në bujqësi.[103]

95 'Propozimligji i ri për provën publikohet në ENER (Нов предлог Закон за пробација објавен на ЕНЕР)', Faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 5 shtator 2025, https://pravda.gov.mk/vest/6874.

96 'Aktakuzë kundër ish-drejtorit dhe shtatë punonjësve të burgut të Shutkës për transferim të paligjshëm të të dënuarve (Обвинение против ексдиректорот и седум вработени во затворот во Шутка за незаконско изнесување осуденици)', Sdk.mk, 8 korrik 2025, https://sdk.mk/index.php/makedonija/obvinenie-protiv-direktorot-i-sedum-vraboteni-vo-zatvorot-vo-shutka-za-nezakonsko- biznuvane-osudenitsi/.

97 'Gjykata Penale me letër të hapur drejtuar drejtorit të burgut të Shutkës për shkak të mos shoqërimit të të pandehurve (Кривичен суд со отворено писмо до директорот на затворот Шутка поради неспроведување на обвинети)', 24.mk, 19 gusht 2025, https://24.mk/details/krivichen-sud-so-otvoreno-pismo-do-direktorot-na-zatvorot-shutka-poradi-nesproveduvanje-na-obvineti.

98 'I dënuari sulmon policin e burgut në Idrizovë (Осуденик нападна затворски полицаец во Идризово)', Telma TV, 25 gusht 2025, https://telma.com.mk/2025/08/25/osudenik-napadna-zatvorski-policzaecz-vo-idrizovo/.

99 'Një vajzë 14-vjeçare qëndron e vetme në një qeli në "Idrizovë" për 22 orë në ditë, afër Tetovës ka një shtëpi për të mitur pa kushte për vajza (14-годишно девојче седи само во ќелија во „Идризово" по 22 часа на ден, кај Тетово има дом за малолетници без услови за девојчиња)', Sloboden Pecat, 9 shtator 2025, https://www.slobodenpecat.mk/14-godishno-devojche-sedi-samo-vo-kjelija-vo-idrizovo-po-22-chasa-na-den-kaj-tetovo-ima-dom-za-maloletnici-bez-uslovi-za-devojchinja/.

100 'Vajza 14-vjeçare e cila ishte e mbyllur për 22 orë në ditë në "Idrizovë" është transferuar në Institucionin Korrektues "Tetovë" (14-годишното девојче кое беше заклучено по 22 часа на ден во „Идризово", е префрлено во Воспитно-поправниот дом „Тетово")', Sloboden Pecat, 9 tetor 2025, https://www.slobodenpecat.mk/14-godishnoto-devojche-koe-beshe-zakluchено-po-22-chasa-na-den-vo-idrizovo-prefrleno-e-vo-vospitno-popravniot-dom-tetovo/.

101 'Nuk ka klasa në Institucionin Edukativo-Korrektues të Tetovës — Ministria e Arsimit hesht për problemin (Нема настава во Воспитно-поправниот дом „Тетово" — Министерството за образование молчи за проблемот)', Sloboden Pecat, 24 shtator 2025, https://www.slobodenpecat.mk/nema-nastava-vo-vospitno-popravniot-dom-tetovo-ministerstvoto-za-obrazovanie-molchi-za-problemot/.

102 'Rritje e mbipopullimit në burgjet Evropiane', (Increasing overcrowding in European prisons), Faqja zyrtare e Këshillit të Evropës, 18 korrik 2025, https://www.coe.int/en/web/portal/-/increasing-overcrowding-in-european-prisons

103 'Të dënuarit do të mësojnë bujqësi, seksioneve të burgut do t'u caktohet tokë për kultivim. (Осудениците ќе учат земјоделие, на затворските одделенија ќе им се додели земјиште за обработка)', Sloboden Pecat, 9 shtator 2025, https://www.slobodenpecat.mk/osudenicite-kje-uchat-zemjodelie-na-zatvorskite-oddelenija-kje-im-se-dodeli-zemjishte-za-obrabotka/

Mbrojtja e të dhënave personale

Në shtator, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (AMDP) nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Transformimit Digjital, duke konfirmuar angazhimin dhe interesin e përbashkët për promovimin e bashkëpunimit midis dy institucioneve, veçanërisht me AMDP-në që ofron trajnime dhe ndihmë të përshtatshme për harmonizimin me rregulloret në fushën për të cilën Ministria është përgjegjëse, me rregulloret mbi mbrojtjen e të dhënave personale.[104] Për më tepër, u organizua një sesion trajnimi mbi sigurinë në përpunimin e të dhënave personale, i cili prezantoi përditësimet e fundit të Rregullores për Sigurinë e të Dhënave Personale dhe shqyrtoi detajisht detyrimet e kontrollorëve dhe përpunuesve.[105]

Liria e shprehjes

Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGPM) bëri thirrje për një rritje urgjente të pagës minimale, në mënyrë që të ruhet dinjiteti i gazetarëve dhe punonjësve të medias, në një shoqëri ku më shumë se 50% e punonjësve të medias kanë të ardhura nën mesataren kombëtare, dhe një pjesë e madhe e tyre fitojnë vetëm një pagë minimale.[106]

Filluan përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme lokale, të planifikuara të mbahen në gjysmën e dytë të tetorit. Pasi u shpallën, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (ASHMAA) filloi monitorimin e transmetuesve në të njëjtën mënyrë si para fillimit të fushatës zgjedhore. Deri në fillim të fushatës zgjedhore, ASHMAA do të kryejë monitorimin ditor të nëntë shërbimeve të programeve televizive në nivel shtetëror, me audiencën më të madhe mesatare ditore, ndërsa të gjitha shërbimet e tjera të programit do të monitorohen në bazë të ankesave.[107]

Trupi Koordinues, përgjegjës për trajtimin e ankesave në lidhje me shkeljet e Kodit të Sjelljes në Hapësirën Online gjatë Proceseve Zgjedhore dhe Referendumeve, u riaktivizua dhe mbajti takimin e tij të parë,[108] si një mekanizëm për mbrojtjen dhe respektimin e së drejtës së lirisë së shprehjes dhe informimit.[109]

KSHZ mori gjithsej 352 aplikime për regjistrim në regjistrin e transmetuesve, mediave të shtypura, mediave elektronike dhe portaleve të internetit për Zgjedhjet Lokale 2025, nga të cilat 33 janë stacione televizive, 42 janë radio stacione, tetë janë media të shtypura dhe 246 janë portale interneti. Përafërsisht 6.5 milionë euro do të shpenzohen për reklama politike të paguara në media, ose 66% të buxhetit të përgjithshëm të KSHZ-së për zgjedhjet lokale.[110]

104 Nënshkrohet memorandum bashkëpunimi mes Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrisë të Transformimit Digjital (Потпишан Меморандум за соработка помеѓу Агенцијата за заштита на личните податоци и Министерството за дигитална трансформација), 5 shtator 2025, https://bit.ly/47GejmE

105 ' Trajnim mbi 'Sigurinë e përpunimit të të dhënave personale' (Обука за „Безбедност на обработката на личните податоци"), Agjencia e Mbrojtjes të të Dhënave Personale e Maqedonisë së Veriut, 30 shtator 2025, https://bit.ly/47RzOPX

106 'SPGPM kërkon rritje të pagës minimale për të ruajtur lirinë e medias dhe dinjitetin e gazetarëve (ССНМ бара зголемување на минималната плата за да се зачува слободата на медиумите и достоинството на новинарите)', Radio MOF, 7 gusht 2025, https://www.radiomof.mk/ssnm-bara-zgolemuvanje-na-minimalnata-plata-za-da-se-zachuva-slobodata-na-mediumite-i-dostoinstvoto-na-novinarite/.

107 'ASHMAA do të monitorojë raportimin e mediave në periudhën parazgjedhore (АВМУ ќе врши мониторинг на медиумското известување во предизборниот период)', Faqja zyrtare e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, 9 gusht 2025, https://bit.ly/3LuncqC.

108 'Mbledhje e Trupit Koordinues për raportimin dhe trajtimin e ankesave gjatë zgjedhjeve ose referendumeve të mbajtura (Одржан состанок на Координативното тело за пријавување и постапување по претставки за време на избори или референдум)', Faqja zyrtare e Kodit të Sjelljes në Sferën Online gjatë Proceseve Zgjedhore dhe Referendumeve, 21 gusht 2025, https://bit.ly/47I0XEZ.

109 'Riaktivizohet mekanizmi për ankesat në lidhje me aktivitetet zgjedhore në hapësirën online (Реактивиран механизмот за жалби поврзани со изборните активности во онлајн просторот)', Vistinomer, 14 gusht 2025, https://bit.ly/4nHJkuZ.

110 '246 portale, 33 stacione televizive dhe 42 radio stacione të regjistruara në KSHZ do të shpenzojnë 6.5 milionë euro nga buxheti për reklamimin e zgjedhjeve lokale (За рекламирање за локалните избори во ДИК регистрирани 246 портали, 33 телевизии и 42 радиостаници, ќе се потрошат 6,5 милиони евра од буџетот)', Sdk.mk, 23 gusht 2025, https://sdk.mk/index.php/makedonija/za-reklamirane-za-lokalnite-izbori-vo-dik-registrirani-246-portali-33-televizii-42-radiostanitsi-ke-potroshat-6-5-milioni-evraod-budhetot/.

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) ka paralajmëruar se Kodi Zgjedhor aktual nuk përmban kritere të qarta se cilat media online lejohen të marrin fonde për reklamim politik të paguar, gjë që krijon hapësirë për korrupsion të mundshëm mes partive dhe mediave, pasi disa nga "portalet" janë faqe interneti me pronar të panjohur ose pa impressum, shpesh të krijuara rishtazi para zgjedhjeve me qëllimin e vetëm për të derdhur para shtetërore në fushatat partiake.[111] Nga ana tjetër, partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje akuzuan ASHMAA-në se i pengonte ata të hynin në reklamat në mediat tradicionale në nivel kombëtar përpara zgjedhjeve.[112]

Në shtator, dolën pretendime në lidhje me mbikëqyrjen e paligjshme nga ASK, e cila paraqiti një kallëzim penal në Prokurorinë Themelore Publike, duke pretenduar se një drejtor i mëparshëm i ASK kishte monitoruar mediat dhe kontaktet në lidhje me opozitën.[113] SPGPM dhe SHGM u përgjigjën me shqetësim, duke theksuar se çdo mbikëqyrje e fshehtë e gazetarëve ose punonjësve të medias paraqet një kërcënim serioz për lirinë e shprehjes, të drejtën e qytetarëve për informacion dhe demokracinë.[114] Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit deklaroi se po heton rastin.[115]

Gjatë kësaj periudhe tremujore, ka pasur disa incidente në të cilat gazetarët dhe ekipet e mediave u sulmuan. Një ekip mediatik po raportonte për një deponi që mori flakë në fillim të korrikut,[116] kur ata u sulmuan fizikisht dhe pajisjet e tyre u shkatërruan.[117] SHGM[118] dhe SPGPM[119] e dënuan këtë ngjarje, dhe Prokuroria Themelore Publike Shkup ngriti aktakuzë,[120] në bazë të së cilës Gjykata Penale Shkup shqiptoi dënim me kusht për të pandehurit.[121] Raste të tjera të presionit mbi mediat përfshijnë ngacmimin në internet të një gazetareje[122] dhe oficerët e policisë që afrohen dhe kërkojnë identifikimin e gazetarëve ndërsa raportonin për një ngjarje me interes të lartë publik, edhe kur ishte e qartë se ata ishin punonjës të mediave me pajisje profesionale.[123]

111 'SHGM paralajmëron: Mungesa e rregullave për reklamim politik me pagesë në mediat online krijon rreziqe korrupsioni (ЗНМ алармира: Недостигот на правила за платена политичка реклама во онлајн медиумите создава корупциски ризици)', Faqja zyrtare e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, 15 gusht 2025, https://bit.ly/4oq5T8E.

112 'Apasiev: Qeveria dëshiron të dëmtojë Levicën me 400,000 euro dhe ta ndalojë atë nga qasja në mediat kombëtare (Апасиев: Владата сака да ја оштети Левица за 400.000 евра и да ѝ забрани пристап до националните медиуми)', Sloboden Pecat, 24 shtator 2025, https://www.slobodenpecat.mk/apasiev-vladata-saka-da-ja-oshteti-levica-za-400-000-evra-i-da-%d1%9d-zabrani-pristap-do-nacionalnite-mediumi/.

113 'ASK denoncoi një ish-drejtor në Prokurorinë Publike, se kishte monitoruar disa media dhe kontaktet e tyre opozitare (АНБ пријавила пред Обвинителството поранешен директор, истражила дека следел некои медиуми и нивни контакти од опозицијата)', Sdk.mk, 29 gusht 2025, https://sdk.mk/index.php/makedonija/anb-prijavila-pred-obvinitelstvoto-poraneshen-direktor-istrazhila-deka-sledel-nekoi-mediumi-i-nivni-kontakti-od-opozitsijata/.??

114 'SHGM dhe SPGPM: Dyshimet për përgjimin e gazetarëve duhet të sqarohen plotësisht (ЗНМ и ССНМ: Потребно е целосно расветлување на сомнежите за прислушување на новинари)', Faqja zyrtare e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, 2 shtator 2025, https://bit.ly/47zzir2.

115 'Spasovski kërkon hetim urgjent për mbikëqyrjen, Rexhepi refuzon të thërrasë një seancë të komitetit (Спасовски бара итна истрага за следењето, Реџепи одбива да свика комисиска седница)', Telma TV, 3 shtator 2025, https://telma.com.mk/2025/09/03/spasovski-bara-itna-istraga-za-sledeneto-redhepi-odbiva-da-svika-komisiska-sednicza/.

116 'Tymi nga Vizbegu "mbyti" Shkupin (Чадот од Визбегово го „задуши" Скопје)', Deutsche Welle, 9 korrik 2025, https://www.dw.com/mk/cadot-od-vizbegovo-go-zadusi-skopje-gorat-stari-vozila-i-se-slusaat-detonacii/a-73213399.

117 'Ekipi i gazetarëve sulmohet në Vizbeg, pengohen nga raportimi i zjarrit (Нападната новинарска екипа во Визбегово, ги спречиле да известуваат за пожарот)', TV 21, 9 korrik 2025, https://mk.tv21.tv/napadnata-novinarska-ekipa-vo-vizbegovo-gi-sprechile-da-izvestuvaat-za-pozharot/.

118 'SHGM: Dënimi i fortë i sulmit ndaj ekipit të gazetarëve të Alsat M në Vizbeg (ЗНМ: Остра осуда за нападот врз новинарска екипа на АЛСАТ М во Визбегово)', Faqja zyrtare e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, 9 korrik 2025, https://bit.ly/4408mhT.

119 'SPGPM: Dënimi i fortë i sulmit ndaj ekipit të Alsat M (ССНМ: Остра осуда за нападот врз екипата на Алсат М)', Faqja zyrtare e Unionit të Pavarur të Gazetarëve dhe Mediave, 10 korrik 2025, https://ssnm.org.mk/soopstenija/ssnm-ostra-osuda-za-napadot-vrz-ekipata-na-alsat-m.

120 'Sulmi ndaj gazetarëve në Vizbeg – Prokuroria Publike ngriti aktakuzë kundër dy personave (Нападот врз новинарите во Визбегово – Обвинителството поднесе обвинение против две лица)', TV 21, 15 korrik 2025, https://mk.tv21.tv/napadot-vrz-novinarite-vo-vizbegovo-obvinitelstvoto-podnese-obvinenie-protiv-dve-litsa/.

121 'Pronarët e deponisë në Vizbeg morën dënime të pezulluara për sulmin ndaj një ekipi mediatik (Условна казна за напад на новинарска екипа добија сопствениците на депонијата во Визбегово)', Radio Evropa e Lirë, 25 korrik 2025, https://www.slobodnaevropa.mk/a/33483567.html.

122 'SPGPM dënon dhe kërkon që ngacmimi në internet i gazetares Miroslava Simonovska të ndalet menjëherë (ССНМ го осудува и бара онлајн малтретирањето на новинарката Мирослава Симоновска веднаш да престане)', Radio MOF, 15 gusht 2025, https://www.radiomof.mk/ssnm-go-osuduva-i-bara-onlajn-maltretiranjeto-na-novinarkata-miroslava-simonovska-vednash-da-prestane/.

123 'SHGM dhe SPGPM shprehin shqetësimin për trajtimin e gazetarëve nga oficerët e policisë në Demir Hisar (ЗНМ и ССНМ изразуваат загриженост за постапувањето на полициските службеници кон новинарите во Демир Хисар)', Radio MoF, 12 gusht 2025, https://www.radiomof.mk/znm-i-ssnm-izrazuvaat-zagrizhenost-za-postapuvanjeto-na-policiskite-sluzhbenici-kon-novinarite-vo-demir-hisar/.

Grupet e cenueshme dhe parimi i mosdiskriminimit

Midis korrikut dhe shtatorit, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMD) nxori disa vendime dhe mendime. Në korrik, KPMD lëshoi një rekomandim të përgjithshëm për komunat, duke u bërë thirrje atyre të ndërmarrin masa dhe aktivitete sistematike dhe jodiskriminuese për të siguruar strehim adekuat, planifikim urban, legalizim të shtëpive, lidhje me infrastrukturën publike, si dhe mbështetje administrative dhe shërbime për anëtarët e popullsisë që jetojnë në vendbanime informale dhe nën standarde, veçanërisht romët.[124] Ai nxori disa vendime që përcaktojnë diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë për arsye të ndryshme, duke përfshirë rastet e mëposhtme: pushimi nga puna i një punonjësi të tekstilit pasi kërkoi pushim mjekësor për t'u kujdesur për fëmijën e saj dyvjeçar;[125] pushimi nga puna i një punonjëseje pasi ajo njoftoi shtatzëninë e saj;[126] diskriminimi në bazë të gjinisë dhe moshës;[127] diskriminimi në fushën e qasjes në kujdesin shëndetësor në bazë të aftësisë së kufizuar në disa spitale psikiatrike;[128] pushimi nga puna i një mësuesi të edukimit fizik në bazë të përkatësisë së tij të supozuar politike;[129] diskriminimi në fushën e qasjes në strehim adekuat për grupet e margjinalizuara, kryesisht qytetarë romë, në komuna të ndryshme.[130]

Disa zhvillime, përfshirë zhvillimet legjislative, u shpalosën në periudhën raportuese në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Në korrik, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) njoftoi se, për herë të parë, asistentët arsimorë do të punësohen jo vetëm në shkollat fillore, por edhe në shkollat e mesme, në fuqi nga shtatori 2025, pas ndryshimeve të fundit ligjore që synojnë përmirësimin e gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor.[131] Megjithatë, ministri deklaroi më tej se punësimi i përhershëm i asistentit arsimor nuk është i mundur,[132] pavarësisht reagimeve nga prindërit dhe asistentët arsimorë.[133] Thirrja publike për asistentë arsimorë në arsimin e mesëm u publkua më 5 gusht.[134] Në dritën e zgjedhjeve lokale të planifikuara për 19 tetor, zbatimi i vendimit gjyqësor nga Gjykata e Apelit në Shkup ka dështuar, me shumë boshllëqe të vazhdueshme për ushtrimin e së drejtës së votës, duke përfshirë shumë qendra votimi që ende nuk kanë qasshmëri fizike për personat me aftësi të kufizuara, ndërsa institucionet dhe partitë nuk përballen me asnjë mekanizëm të dukshëm zbatimi për të siguruar pajtueshmërinë.[135]

124 "Rekomandim i përgjithshëm për strehimin (Општа препорака за домување)," Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, 9 korrik 2025, https://bit.ly/4p5oKG3.

125 'Punëtorja e tekstilit u pushua nga puna për marrjen e pushimit mjekësor për t'u kujdesur për dy-vjeçarin me linë e dhenve (Конфекциска работничка избркана од работа зашто побарала боледување за да се грижи за двегодишното дете со сипаници) ', Sakam Da Kazam, 19 korrik 2025, https://sdk.mk/index.php/makedonija/konfektsiska-rabotnichka-izbrkana-od-rabota-zashto-pobarala-boleduvane-za-da-se-grizhi-za-dvegodishnoto-dete-so-sipanitsi/.

126 "Opinioni nr.08-352/6 (Мислење бр.08-352/6),» Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, 23 shtator 2025, https://bit.ly/43oc6JV.

127 'Një grua fitoi një rast diskriminimi pas raportimit të një kompanie të Shkupit që ndaloi burrat të aplikojnë për një pozicion të menaxherit financiar (Жена доби случај за дискриминација откако пријави скопска фирма која забранува на оглас за финансиски менаџер да се пријавуваат мажи)', Sakam Da Kazam, 28 shtator 2025, https://sdk.mk/index.php/neraskazhani-prikazni/zhena-dobi-sluchaj-za-diskriminatsija-otkako-prijavi-skopska-firma-koja-zabranuva-na-oglas-za-finansiski-menadher-da-se-prijavuva-mati/.

128 "Opinioni nr.08-29/15 (Мислење бр.08-29/15),» Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, 1 shtator 2025, https://bit.ly/43Xyie0.

129 "Opinioni nr.08-556/6 (Мислење бр.08-556/6),» Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, 19 shtator 2025, https://bit.ly/4qX8itc.

130 "Opinioni nr.08-46/2 (Мислење бр.08-46/2),» Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, 7 korrik 2025, https://bit.ly/47DCCl9.

131 "Nga shtatori, për herë të parë do të ketë asistentë arsimorë si në arsimin fillor ashtu edhe në atë të mesëm - numri më i lartë deri më tani, njoftoi Ministria e Arsimit dhe Shkencës (Од септември за прв пат образовни асистенти ќе има и во основните и во средните училишта, најмногу досега, соопшти МОН),» Makfax News Agency, 15 korrik 2025, https://bit.ly/4i04sLR.

132 'Janevska: Nuk ka punësim të përhershëm për asistentët arsimorë (Јаневска: Нема трајно вработување за образовните асистенти)', Radio Evropa e Lirë, 20 korrik 2025, https://www.slobodnaevropa.mk/a/33477668.html.

133 'Prindërit dhe edukatorët specialë të mbingarkuar nga vala e re e punësimit të asistentëve arsimor (Родители и специјални едукатори извисени со новиот бран вработувања на образовни асистенти)', Radio MOF, 19 korrik 2025, https://www.radiomof.mk/roditeli-i-specijalni-edukatori-izviseni-so-noviot-bran-vrabotuvanja-na-obrazovni-asistenti/.

134 'Thirrje publike për punësimin e 83 asistentëve arsimorë (Јавен оглас за вработување на 83 образовни асистенти)', DSU për Rehabilitimin dhe Arsimin 'Shën Naum Ohridski', 6 gusht 2025, https://www.dsu-svnaumohridski.edu.mk/aktivnost/85874/javen-oglas-za-vrabotuvanje-na-83-obrazovni-asistenti/.

135 "Vendimi i gjykatës nuk është i mjaftueshëm, askush nuk do t'u thotë partive të zhvillojnë material zgjedhor për personat me aftësi të kufizuara dhe komunat të instalojnë rampa për karrige me rrota në qendrat e votimit (Џабе судска пресуда, нема кој да им каже на партиите да изработат изборен материјал за лицата со попреченост и на општините да стават рампи за инвалидски колички на избирачките места)," Sakam Da Kazam, 12 gusht 2025, https://bit.ly/4nTByya.

Përveç kësaj, ka pasur kërkesa publike për procedura të thjeshtuara të dokumentacionit gjatë aplikimit për ndihmë financiare, duke nënvizuar pengesat burokratike me të cilat përballen shumë qytetarë me aftësi të kufizuara.[136] Për më tepër, prindërit dhe kujdestarët po bëjnë thirrje për njohjen formale të profesionit 'prind-kujdesës', duke siguruar mbrojtjen e tyre sociale dhe të drejtat e punës.[137]

Në korrik, Qeveria e Maqedonisë së Veriut propozoi ndryshime në Ligjin për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, të cilat do t'u mundësojnë punësim personave me çrregullime të spektrit të autizmit dhe çrregullime të tjera zhvillimore.[138] Për më tepër, në shtator, Kuvendi i Maqedonisë së Veriut miratoi Ligjin për Qasjen në Faqet e Internetit dhe Aplikacionet Mobile të Institucioneve të Sektorit Publik,[139] megjithatë legjislacioni ende përjashton sektorin privat dhe nuk përfshin pajisjet digjitale ndihmëse, të cilat mbeten kryesisht të papërballueshme ose pa mbështetje nga shteti.[140]

Gjinia

Ministri i Drejtësisë njoftoi se me ndryshimet e fundit të propozuara në Kodin Penal, autorët e dhunës në familje do të ndiqen penalisht sipas detyrës zyrtare, edhe pa paraqitur ankesë viktima, duke bërë kështu një ndryshim sistematik që lehtëson viktimat nga presioni dhe frika e hakmarrjes.[141]

Kryeministri njoftoi se Qeveria po konsideron futjen e taksave shtesë për njerëzit e vetëm dhe njerëzit e pamartuar për shkak të sfidave demografike me të cilat përballet vendi, siç matet me më pak martesa dhe më pak lindje.[142] Rrjeti për Mbrojtjen nga Diskriminimi reagoi duke deklaruar se është një kërcënim për të drejtat themelore të njeriut dhe parimet e barazisë dhe lirisë, dhe se një taksë e tillë do të ngarkonte të rinjtë, prindërit e vetëm, personat LGBTI+ dhe ata që janë të cenueshëm nga pikëpamja sociale dhe ekonomike.[143]

Në një rast të veçantë, Platforma për Barazi Gjinore iu përgjigj propozim-ndryshimeve të Ligjit për Policinë, të cilat u paraqitën në Kuvend, duke propozuar shfuqizimin e dispozitës që detyron respektimin e parimit të barazisë në punësim brenda policisë. Në përgjigje thuhet se shfuqizimi i këtij neni dërgon një mesazh të rrezikshëm se barazia gjinore dhe gjithëpërfshirja janë të parëndësishme në ndërtimin e institucioneve të sigurisë, dhe një propozim i tillë paraqet një shqetësim serioz për shkak të rasteve të shumta të trajtimit të papërshtatshëm dhe mbrojtjes joefektive nga policia, veçanërisht në rastet e dhunës me bazë gjinore dhe në familje.[144]

136 'Personat me aftësi të kufizuara kërkuan më pak dokumentacion për të marrë ndihmë (Помалку документација за добивање помош побараа лицата со попреченост)', Независен, 10 korrik 2025, https://nezavisen.mk/pomalku-dokumentacija-za-dobivanje-pomosh-pobaraa-licata-so-poprechenost/.

137 'Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara kërkojnë njohjen e profesionit të prindit kujdestar (Да се признае професија родител-негувател, бараат родителите на деца со попреченост)', Telma TV, 12 korrik 2025, https://telma.com.mk/2025/07/12/da-se-priznae-profesija-roditel-neguvatel-baraat-roditelite-na-decza-so-poprechenost/.

138 'Propozimligji për ndryshimin e Ligjit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara (Предлог на Закон за изменување на законот за вработување на инвалидни лица)', Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 25 korrik 2025, https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal.nspx?param=c0ef645f-0d64-4103-8e5a-b3e8d2690957.

139 Dekret për shpalljen e Ligjit për qasshmërinë e faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare të institucioneve të sektorit publik (Указ за прогласување на Законот за пристапност на вебстраниците и мобилните апликации на институциите од јавниот сектор), Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut no.193/2025 (Службовы весник на Република Северна Македонија бр. 193/2025) (2025), https://portal.mdt.gov.mk/post-body-files/zakoni-mdt-file-YJSL.pdf.

140 'Klikimi i parë drejt qasshmërisë institucionet do të përshtasin faqet e internetit për personat me aftësi të kufizuara, por pabarazia mbetet (Прв клик кон пристапноста - институциите ќе ги прилагодат сајтовите за лицата со попреченост, но нееднаквоста останува)', Prizma.mk, 19 gusht 2025, https://prizma.mk/prv-klik-kon-pristapnosta/.

141 'Dhuna në familje do të ndiqet penalisht sipas detyrës zyrtare me ndryshimet e reja në Kodin Penal (Семејното насилство ќе се гони по службена должност со новите измени во Кривичниот закон)', Sitel TV, 15 korrik 2025, https://sitel.com.mk/semejnoto-nasilstvo-kje-se-goni-po-sluzhbena-dolzhnost-so-novite-izmeni-vo-krivichniot-zakon.

142 'Ne po shqyrtojmë taksa shtesë për të pamartuarit, tha Mickoski (Размислуваме за дополнителни даноци за немажени и неженети, рече Мицкоски)', Sdk.mk, 4 korrik 2025, https://sdk.mk/index.php/makedonija/razmisluvame-za-dopolnitelni-danotsi-za-nemazheni-i-nezheneti-reche-mitskoski/.

143 'Qeveria nuk e di se sa do të jetë taksa për beqarët dhe nga cila moshë do të paguhet, ata thonë se masa është ende në fazën e shqyrtimit (Владата не знае колкав ќе биде данокот за немажени и неженети и од која возраст ќе се плаќа, велат дека мерката уште е во фаза на размислување)', Sdk.mk, 5 korrik 2025, https://sdk.mk/index.php/makedonija/vladata-ne-znae-kolkav-ke-bide-danot-za-nemazhenii-nezheneti-i-od-koja-vozrast-ke-se-plaka-velat-deka-merkataushte-e-vo-faza-narazmislvane/.

144 'Reagim: Shfuqizimi i nenit 96 të Ligjit për Policinë është një hap i rrezikshëm prapa: barazia, përfaqësimi dhe besimi në polici nuk duhet të vihen në pikëpyetje (Реакција: Укинувањето на член 96 од Законот за полиција е опасен чекор наназад: еднаквоста, застапеноста и довербата во полицијата не смеат да бидат доведени во прашање)', Faqja zyrtare e Platformës për Barazi Gjinore, 17 korrik 2025, https://bit.ly/3LYTB8M.

KPMD ngriti padi kundër Qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë në Gjykatën Themelore Civile Shkup për shkak se ato nuk përfshinë fermerët femra në dispozitën e Ligjit për Sigurimin Shëndetësor që rendit përfituesit e kompensimit të pushimit të lehonisë. Ndërsa ekziston një program vjetor që ndan fonde për kompensimin e pushimit të lehonisë për fermerët femra, një zgjidhje sistematike e kësaj çështjeje nuk është arritur ende.[145]

Në fillim të shtatorit, Rrjeti Kombëtar për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, së bashku me Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, organizuan një punëtori në të cilën u krijua zyrtarisht organi multisektorial për monitorimin e rasteve të femicidit dhe tentim-vrasjes. Ky hap u ndërmor për të siguruar një qasje sistematike dhe të koordinuar për parandalimin dhe monitorimin e femicidit, si dhe krijimin e politikave për mbrojtje dhe parandalim më të mirë të dhunës me bazë gjinore.[146]

Në fund të shtatorit, u mbajt seanca konstituive e Trupit Kombëtar Koordinues për Zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, gjatë së cilës u prezantuan të gjitha dokumentet dhe aktivitetet e miratuara dhe të zbatuara deri më sot.[147]

Komisioni për Kompensimin Financiar të Viktimave të Krimeve të Dhunshme mori gjithsej 54 kërkesa për kompensim nga viktimat e dhunës; megjithatë, ai miratoi vetëm një pagesë prej 500 EUR, ndërsa pjesa tjetër u refuzua si e pabazuar (32) ose është në vazhdim (21).[148]

Më 11 korrik, gjatë inspektimit të një ndërtimi të paligjshëm, Kryetarja e Qytetit të Shkupit u sulmua fizikisht dhe u kërcënua.[149] Sipas llogarisë së saj, sulmuesit e kërcënuan verbalisht me përdhunim dhe vrasjen e familjes së saj, dhe e goditën atë para oficerëve të policisë që nuk ndërhynë.[150] Rrjeti Kombëtar për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje e dënoi me forcë sulmin, duke deklaruar se ai sulmoi dinjitetin e grave në përgjithësi dhe gjithashtu demonstroi se kërcënimet, nënçmimi dhe dhuna gjithnjë e më shumë synojnë politikanet femra.[151] Policia ndaloi dy të dyshuar, ndërsa Prokuroria Themelore Publike Shkup ngriti një padi kundër një individi për dhunë.[152] Gjykata Themelore Penale Shkup e shpalli fajtor të pandehurin dhe e dënoi me dy vjet burgim.[153]

145 'Padi e ngritur kundër shtetit sepse fermeret femra nuk kanë pushim të lehonisë (Поднесена тужба против државата зашто земјоделките немаат породилно отсуство)', Sdk.mk, 18 korrik 2025, https://sdk.mk/index.php/makedonija/podnesena-tuzhba-protiv-drzhavata-zashto-zemjodelkite-nemaat-porodilno-otsustvo/.

146 'Observatori i femicidit: Një mekanizëm i ri për mbrojtjen dhe parandalimin (Опсерваторијата за фемициди: Нов механизам за заштита и превенција)', Faqja zyrtare e Rrjetit Kombëtar kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, 9 shtator 2025, https://glasprotivnasilstvo.org.mk/opservatorijata-za-femitsidi-nov-mehanizam-za-zashtita-i-preventsija/.

147 ' Mbahet seanca konstituive e Trupit Kombëtar Koordinues për Zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Одржана конститутивна седница на Националното координативно тело за имплементација на Конвенцијата на Совет на Европа за спречување и борба против насилство врз жените и семејното насилство)', Faqja zyrtare e Ministrisë së Politikave Sociale, Demografisë dhe Rinisë, 25 shtator 2025, https://www.mtsp.gov.mk/pocetna-ns_article-odrzana-konstitutivna-sednica-na-nacionalnoto-koordinativno-telo-za-implementacija-na-konvencijata-n.nspx.

148 'Nga 54 kërkesa për kompensim për viktimat e dhunës dhe vrasjes së të dashurve, shteti miratoi vetëm një pagesë prej 500 eurosh (Од 54 барања за надомест на жртви на насилство и за убиство на блиски, државата одобрила само една исплата од 500 евра)', Sdk.mk, 29 shtator 2025, https://sdk.mk/index.php/neraskazhani-prikazni/od-54-barana-za-nadomest-na-zhrtvi-na-nasilstvo-i-za-ubistvo-na-bliski-drzhavata-odobrila-samo-edna-isplata-od-500-evra/.

149 'Kryetarja e Komunës Danella Arsovska u sulmua në Çair (Градоначалничката Данела Арсовска нападната во Чаир)', Deutsche Welle, 11 korrik 2025, https://www.dw.com/mk/gradonacalnickata-na-skopje-danela-arsovska-napadnata-vo-cair-mi-se-zakanuvaa-na-mene-i-moeto-semejstvo/a-73244229.

150 'Kryetarja Arsovska mori siguri policore 24-orëshe (Градоначалничката Арсовска доби 24-часовно полициско обезбедување)', Radio Evropa e Lirë, 12 korrik 2025, https://www.slobodnaevropa.mk/a/arsovska-napad-policija/33472367.html.

151 'Rrjeti Kombëtar kundër Dhunës ndaj Grave dënon fuqishëm sulmin brutal ndaj kryetares Danella Arsovska (Националната мрежа против насилство врз жени со најостра осуда за бруталниот напад врз градоначалничката Данела Арсовска)', Makfax, 11 korrik 2025, https://bit.ly/4pltdET.

152 'Aktakuzë e ngritur kundër njeriut që fyeu dhe kërcënoi Danella Arsovska (Поднесено обвинение за мажот кој ја навредуваше, па и се заканува на Данела Арсовска)', A1 On, 18 korrik 2025, https://a1on.mk/macedonia/podneseno-obvinenie-za-mazhot-koj-ja-navreduvashe-pa-i-se-zakanuvashe-na-danela-arsovska/.

153 'Sulmuesi i kryetares Danella Arsovska u dënua me dy vjet burg (Напаѓачот на градоначалничката Данела Арсовска доби две години затвор)', Radio MOF, 2 shtator 2025, https://www.radiomof.mk/napagjachot-na-gradonachalnichkata-danela-arsovska-dobi-dve-godini-zatvor/.

Më 15 shtator në Veles, një grua dhe babai i saj u vranë nga ish-partneri i saj, i cili më pas kreu vetëvrasje.[154] Ajo kishte paraqitur më parë raporte të shumta për kërcënime dhe dhunë nga ish-partneri i saj, duke përfshirë kërcënime ndaj familjes së saj, si dhe sulme fizike ndaj saj dhe dëmtime të pronës.[155] Megjithëse policia ishte lajmëruar, veprimi institucional duket se ka qenë i pamjaftueshëm për të parandaluar përshkallëzimin fatal. Ministria e Brendshme filloi procedimin disiplinor ndaj 11 oficerëve të policisë për mosveprim ndaj atyre ankesave,[156] ndërsa qytetarët iu përgjigjën tragjedisë duke organizuar një protestë për mosveprimin e tyre.[157]

Të drejtat e fëmijës

Më 8 gusht, Qeveria e Maqedonisë së Veriut miratoi Planin Kombëtar të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2025-2029, duke ndërmarrë një hap të rëndësishëm drejt përmbushjes së angazhimeve të saj ndaj Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve dhe zbatimit të Garancisë Evropiane të të Drejtave të Fëmijëve. Një komponent kyç i planit është krijimi i një mekanizmi kombëtar për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (UNCRC) përmes ndryshimeve në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve. Kjo do të krijojë një organ të specializuar për monitorimin e të drejtave të fëmijëve, i cili do të ketë për detyrë koordinimin e zbatimit të planit, si dhe sigurimin e mbikëqyrjes sistematike të zbatimit të UNCRC.[158]

LGBTI+

Platforma e Barazisë Gjinore lëshoi një thirrje publike përpara zgjedhjeve lokale të vitit 2025, duke kërkuar që të gjitha partitë politike të miratojnë politika lokale dinjitoze për komunitetet e margjinalizuara, duke përfshirë komunitetet lezbike, homoseksuale, biseksuale, trans dhe interseks (LGBTIQ+) dhe të tjerët në kryqëzimin e padrejtësisë sociale.[159] Në korrik, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) publikoi një rregullore mbi mënyrën e raportimit dhe mbrojtjes së një nxënësi-viktimë të cilët janë viktima të dhunës, abuzimit dhe neglizhencës (arsimi fillor),[160] ndaj së cilës Platforma për Barazi Gjinore lëshoi një reagim, duke kritikuar Ministrinë për dështimin për t'i dhënë përparësi masave për të trajtuar dhunën, diskriminimin dhe përjashtimin në arsim, duke argumentuar se rregullorja e re normalizon praktikat e dëmshme në vend që t'i parandalojë ato, veçanërisht për nxënësi LGBTI+.[161]

154 'Ministria e Punëve të Brendshme për tmerrin në Veles: Vrasësi shkoi në shtëpinë e tyre dhe vrau ish-të dashurën e tij dhe babanë e saj me një thikë (МВР за ужасот во Велес: Убиецот им отишол дома и со нож ги убил поранешната девојка и нејзиниот татко)', Sloboden Pecat, 15 shtator 2025, https://www.slobodenpecat.mk/mvr-za-uzhasot-vo-veles-ubiecot-im-otishol-doma-i-so-ostar-predmet-gi-ubil-poraneshnata-sopruga-i-nejziniot-tatko/.

155 'Detaje të reja për tragjedinë e Velesit: Viktima raportoi dhunë në mënyrë të përsëritur (Нови детали за велешката трагедија: жртвата повеќепати пријавувала насилство)', 24 Info, 15 shtator 2025, https://24info.mk/novi-detali-za-veleshkata-tragedija-zhrtvata-povekepati-prijavuvala-nasilstvo/.

156 'Procedura disiplinore ndaj 11 policëve të Velesit – Ata nuk vepruan sipas ankesave të Rosicës (Дисциплинска постапка за 11 велешки полицајци – Не постапувале по пријавите на Росица)', Sloboden Pecat, 26 shtator 2025, https://www.slobodenpecat.mk/disciplinska-postapka-za-11-vraboteni-vo-svr-veles-ne-postapuvale-po-prijavite-na-rosica/.

157 'Protestë para Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe në Parkun e Gruas Luftëtare në Shkup pas vrasjes së 31-vjeçares Rosica dhe babait të saj (Протест пред МВР и во паркот на жената борец во Скопје по убиството на 31-годишната Росица и татко ѝ)', Sdk.mk, 18 shtator 2025, https://sdk.mk/index.php/makedonija/protestë-pred-mvr-i-vo-parkot-na-zhenata-borets-vo-skopje-po-ubistvoto-na-31-godishnata-rositsa-i-tatko/.

158 'Është miratuar Plani Kombëtar i Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve (2025-2029) - një hap sistematik përpara për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve (Усвоен Националниот акциски план за правата на децата (2025–2029)', Ministria e Politikave Sociale, Demografisë dhe Rinisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 8 gusht 2025, https://www.mtsp.gov.mk/pocetna-ns_article-usvoen-nacionalniot-akciski-plan-za-pravata-na-decata-2025-2029-sistemski-iscekor-za-zashtita-i-unap.nspx.

159 "Shpallje për zgjedhjet e ardhshme lokale 2025: Politika të dinjitetshme lokale për komunitetet e margjinalizuara (Проглас за претстојните локални избори 2025: Достоинствени локални политики за маргинализираните заедници)," Platforma e Barazisë Gjinore, 5 shtator 2025, https://bit.ly/4oyDWLT.

160 'Rregullorja për mënyrën e raportimit dhe mbrojtjes së një nxënësi-viktimë të çdo forme të dhunës, abuzimit dhe neglizhencës (arsimi fillor) (Правилник за начинот за пријавување и заштита на ученик-жртва на која било од формите на насилство, злоупотреба и занемарување (основно образование)', Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 7 korrik 2025, https://arhiva.mon.gov.mk/content/?id=10254.

161 'Reagim: Trajtimi i dhunës nuk ka vend në politikat e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (Реакција: Справувањето со насилството нема свое место во политиките на МОН)," Platforma e Barazisë Gjinore, 12 shtator 2025, https://bit.ly/3LK3Hud.

Romët

Pas vizitës në prill, Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut publikoi një memorandum për Maqedoninë e Veriut që trajton të drejtat e romëve dhe të drejtën për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.[162] Raporti pranon përparimin, duke përfshirë miratimin e Strategjisë së Përfshirjes së Romëve 2022–2030 dhe përmirësimet në regjistrimin e shkollave fillore, por thekson boshllëqet e vazhdueshme në zbatim, diskriminimin e vazhdueshëm, ndarjen e shkollave dhe mbrojtjen e dobët kundër abuzimit të policisë. Ai gjithashtu thekson se komunitetet rome janë të ekspozuara në mënyrë disproporcionale ndaj rreziqeve mjedisore për shkak të strehimit joadekuat dhe menaxhimit të mbeturinave. Ndërsa Maqedonia e Veriut ka një kornizë të fortë ligjore për mbrojtjen e mjedisit, zbatimi dhe qasja në drejtësi mbeten të kufizuara. Komisioneri bëri thirrje për koordinim më të fortë institucional, rritje të financimit në nivel lokal, llogaridhënie në zbatimin e ligjit dhe zbatim të plotë të masave mjedisore dhe përfshirjes së romëve. Në këtë drejtim, Ministri pa portofol përgjegjës për përfshirjen dhe zbatimin e Strategjisë së Përfshirjes së Romëve 2022-2030 gjithashtu deklaroi se luftimi i anticiganizmit në Maqedoninë e Veriut kërkon një përgjigje sistematike dhe gjithëpërfshirëse sesa iniciativa të izoluara.[163]

Një vendim gjyqësor historik u dha në korrik: Gjykata Themelore Civile Shkup konstatoi se mosintegrimi i individëve nga 'Regjistri i Veçantë i Lindjeve' në regjistrin e rregullt përbënte diskriminim, duke prekur në mënyrë disproporcionale romët të cilëve më pas iu mohua qasja në të drejta dhe shërbime.[164] Në fund të korrikut, MASH lëshoi dy thirrje publike për vitin shkollor 2025-26: një për të rekrutuar 50 ndërmjetësues arsimorë romë për të mbështetur arsimin fillor dhe një thirrje të re për të rekrutuar 35 ndërmjetës për herë të parë në arsimin e mesëm.[165] Në gusht, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut zbuloi se Maqedonia e Veriut kishte shkelur të drejtat e dy qytetarëve romë në kalimin kufitar në Tabanovce. Në dy raste, në vitin 2014 dhe 2015, ata janë ndaluar të largohen nga vendi pavarësisht se kanë pasaporta dhe dokumentacion të vlefshëm.[166]

Në shtator, Drejtori i Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Shpëtimit në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut deklaroi në një paraqitje publike se familjet rome që jetojnë në vendbanimin joformal Vardrishte duhet të zhvendosen "me një procedurë të shkurtër dhe, nëse është e nevojshme, me forcë".[167] Kjo deklaratë pasoi një shpërthim masiv zjarri në deponinë e Vardarishtës. Avokati i Popullit theksoi se shteti duhet të kërkojë zgjidhje adekuate dhe të qëndrueshme për strehimin në vend që të përdorë dëbimet e detyruara, duke kritikuar vërejtjet publike që bëjnë thirrje për zhvendosje të detyruar të komuniteteve rome si stigmatizuese, diskriminuese dhe në kundërshtim me Kushtetutën, Strategjinë e Përfshirjes së Romëve 2022–2030 dhe ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.[168]

162 'Memorandumi për të drejtat e njeriut të romëve dhe për çështjet që lidhen me të drejtën për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm në Maqedoninë e Veriut', Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës, 29 korrik 2025, https://rm.coe.int/memorandum-on-north-macedonia-by-michael-o-flaherty-council-of-europe-/1680b6bc39.

163 'Nevojitet veprim sistematik në luftën kundër anticiganizmit (Потребна е системска акција во борбата против антициганизмот)', Nezavisen.mk, 15 korrik 2025, https://nezavisen.mk/potrebna-e-sistemska-akcija-vo-borbata-protiv-anticiganizmot/.

164 'Vendimi kryesor i gjykatës për romët në rrezik pashtetësie në Maqedoninë e Veriut (Клучна судска пресуда за Ромите во ризик од бездржавјанство во Северна Македонија)', Shoqata Maqedonase e Avokatëve të Rinj, 17 korrik 2025, https://myla.org.mk/51418/.

165 "MASH shpall dy thirrje për ndërmjetësues arsimorë romë, për herë të parë në arsimin e mesëm (МОН објави два повика за ромски образовни медијатори, за првпат и во средно образование)," Radio MOF, 1 gusht 2025, https://bit.ly/4qXSLZY.

166 "Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut dënon Maqedoninë e Veriut për diskriminim kundër romëve në kufij," (UN Human Rights Committee condemns North Macedonia for anti-Roma discrimination at borders), Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve, 27 gusht 2025, https://bit.ly/49PUmLn.

167 'Stojançe Angellov "do t' i dëbojë me forcë dhe urgjentisht romët nga Vardarishtja" - reagon Shukova: Kjo është kulmi i çnjerëzimit dhe zbulon fytyrën e vërtetë të kësaj Qeverie (Стојанче Ангелов „по кратка постапка и на сила ќе ги сели Ромите од Вардариште" – Шукова со реакција: Ова е врв на нечовечноста и го открива вистинското лице на оваа власт)', Civil Media, 16 shtator 2025, https://civilmedia.mk/stojanche-angelov-po-kratka-postapka-i-na-sila-ke-gi-seli-romite-od-vardarishte-shukova-so-reaktsija-ova-e-vrv-na-nechovechnosta-i-go-otkriva-vistinskoto-litse-na-ovaa-vlast/.

168 'Nevojiten zgjidhje për strehim dinjitoz, jo dëbime të detyruara, thotë Avokati i Popullit (Потребни се решенија за достоинствено домување, а не присилно иселување, вели Народниот правобранител)', 360 Stepeni, 17 shtator 2025, https://360stepeni.mk/potrebni-se-reshenija-za-dostoinstveno-domuvane-a-ne-prisilno-iseluvane-veli-narodniot-pravobranitel/.